



INSTITUCIONET  
MUZEALE  
TË QYTETIT TË  
PRIZRENIT

Botues: EC Ma Ndryshe  
Dhjetor, 2022







## INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË PRIZRENIT

Analizë dhe dokumentim i gjendjes ekszituese të institucioneve muzeale të qytetit të Prizrenit

**Autorë:** Flaka Xërxa Beqiri  
Blerta Breznica  
Marigona Rexha

**Asistent në terren:** Vetim Krasniqi  
Veron Tara

**Botues:** EC Ma Ndryshe

Dhjetor, 2022

Ky hulumtim u realizua nga EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit "Promovimi i trashëgimisë kulturore përmes fuqizimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe inovative në institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit" mbështetur nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport në Prizren.

Përmbajtja dhe rekomandimet e paraqitura këtu janë përgjegjësi e EC dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve.







## PËRMBAJTJA

● Hyrje	1
1 Metodologjia dhe qëllimi i hulumtimit	6
2 Përkufizime mbi zhvillimin historik të institucioneve muzeale, kategorizimet dhe karakteristikat funksionale	7
3 Institucionet muzeale në Kosovë	18
4 Institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit	22
4.1 Gjendja ekzistuese fizike	25
4.2 Operimi, kapacitetet njerëzore dhe shërbimet e ofruara	32
4.3 Analiza e hapësirave dhe sekuencat e lëvizjeve	38
4.4 Qasshmëria e personave me aftësi të kufizuara	42
4.5 Shfytëzueshmëria dhe kënaqshmëria nga ana e qytetarëve	45
4.6 Problemet dhe propozimet	50
● Përfundime dhe rekomandime	54
● Bibliografia	58
Lista e figurave	60
○ Shtojca 1: Dokumentimi dhe analiza e institucioneve muzeale të qytetit të Prizrenit – pjesa grafike	

#### AKRONIMET

MKRS – Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit  
IAK – Instituti Arkeologjik i Kosovës  
KP – Komuna e Prizrenit  
DKRS – Drejtoria për Kulturë, Rinë dhe Sport  
PAK – Persona me Aftësi të Kufizuara

*Muzeu është një institucion "fuqizues", që synon të përfshijë të gjithë ata persona që do të bëhen pjesë e përvojës sonë të përbashkët kulturore. Çdo qytetar mund të hyjë në një muze dhe të vlerësojë arritjet më të larta të kulturës së tij. Nëse shpenzon mjaftueshëm kohë, ai mund të transformohet. Kjo është pikërisht ajo që themeluesit e muzeut kishin parasysh kur sollën koleksione të mëdha në qytetet e tyre.*

Mark Lilla





## HYRJE

Një muze është një institucion jofitimprurës, në mënyrë konstante në shërbim të shoqërisë, që hulumton, mbledh, konservon, interpreton dhe ekspozon trashëgiminë e preکشme dhe të paprekshme. Të hapur për publikun, të aksesueshëm dhe gjithëpërfshirës, muzetë nxisin diversitetin dhe qëndrueshmërinë. Ata veprojnë dhe komunikojnë në mënyrë etike, profesionale dhe me pjesëmarrjen e komuniteteve, duke ofruar përvoja të ndryshme për edukim, rekreim, reflektim dhe shkëmbim njohurish<sup>1</sup>. Si i tillë, muzeu përbën një kategori objektësh arkitektonike të cilat nuk përbëjnë interes për shoqërinë vetëm si struktura fizike dhe kualitete estetike që ato përfaqësojnë, por edhe për institucionalizmin të cilin e bartin si epitete. Më konkretisht, muzetë cilësohen si institucione që kujdesen për koleksionim të artefakteve kulturore, historike dhe shkencore, të cilat i vënë në dispozicion të publikut dhe të cilat, varësisht nga kategorizimi i vet ekzpozitës të cilës i takojnë, mund të jenë pjesë të ekspozitave të përhershme apo të përkohshme<sup>2</sup>.

Në Kosovë, edhe pse nuk ka statistika të publikuara lidhur me numrin e institucioneve muzeale të cilat operojnë në nivel qendror apo lokal<sup>3</sup>, mund të numërojmë dhjetra muze të cilat janë kryesisht të kategorisë së muzeve të historisë, arkeologjisë, etnologjisë dhe diciplinave të tjera të ngjashme.

Menaxhimi dhe funksionimi i muzeve, si kategori e veçantë e institucioneve kulturore, mbeten qështje të ndjeshme duke qenë se Kosova ende nuk e ka të defnuar strukturën legjislative për muzetë, përkundër një angazhimi të vonshëm në drejtim të përmirësimit të kësaj situate. Më konkretisht, legjislative për muzetë, përkundër një angazhimi të vonshëm në drejtim të përmirësimit të kësaj situate. Më konkretisht, Koncept Dokumenti për Art dhe Kulturë i miratuar së fundmi nga Qeveria e Kosovës ndër të tjera përcakton, në cilësinë e objektivës strategjike nr.2, reformimin organizativ, funksional dhe konsolidimin e bređshëm të intitucioneve publike të kulturës dhe të muzeve. Është me interes të ceket se ky dokument vendos në rradhën e objektivave specifike ndër të tjera dhe: (2.1) Krijimin e strukturave me përgjegjesi te përcaktuar qarte ne promovimin kulturor, zhvillimin e hulumtimeve dhe publikimin e studimeve si dhe ruajtjen e trashëgimise dhe krijimtarise kulturore; (2.2) Sigurimin e qendrueshmeri financiare dhe funksionale të institucioneve publike permes decentralizimit te përgjegjesive per menaxhim financiar dhe administrativ te bređshem; (2.3.) Digjitalizimin dhe qasje ne materiale dhe koleksione kulturore; (2.4) Ngritjen e kapaciteteve njerezore ne fushen e kultures dhe krijimit te strukturave funksionale profesionale, teknike, administrative dhe logjistike<sup>4</sup>.

<sup>1</sup> Definicioni i ri i muzeve, propozuar nga Këshilli Nërkombeđtar i Muzeve (ICM – International Council of Museums), aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale mbajtur në Pragë, më 24 Gusht 2022, qasur në Nëntor 2022, <https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/>

<sup>2</sup> Alexander, E.P., Alexander, M., "Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums", Rowman & Littlefield, 2007

<sup>3</sup> EC Ma Ndryshe, "Prizreni 'qytet muze' pa muze?", Maj 2008, qasur në Nëntor 2022, <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530>

<sup>4</sup> MKRS – faqja zyrtare, "Miratohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë" qasur në Nëntor, 2022, <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041#.Y6bo1i-B2X0>

Muzetë priorizohen edhe në kuadër të Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturor 2017 – 2027, në të cilin dokument në kuadër të veprimit orientues 2.1, krahas zhvillimit të mëtejshëm të institucioneve të trashëgimisë kulturore parashihet definimi i statutit të institucioneve të trashëgimisë kulturore dhe themelimi i institucioneve të reja, siç është Muzeu Arkeologjik, Muzeu Etnologjik dhe Muzeu i Historisë së Natyrës. Masat e tjera të përfshira në strategji adresojnë përmirësimin e kapaciteteve profesionale të punonjësve të trashëgimisë kulturore dhe realizimin e programeve trajnuese për ciceronë dhe kuratorë muzeal, menaxherë, laborantë dhe profesionistë të tjerë të fushës<sup>5</sup>.

Sidoqoftë, përmirësimi i strukturës ligjore e edhe ndërmarrja e veprimeve konkrete drej përmirësimi të gjendjes fizike dhe operacionale të muzeve aktiv në Republikën e Kosovës mbeten subjekt i analizës.

Ky hulumtim për institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit vie në një momentum kur muzetë si institucione janë duke u ballafaquar (ndërkombëtarisht) me tendencën për tu transformuar nga hapësira "të vdekura" ku vetëm ka ndodhur ekspozimi i eksponateve të artit shkencës dhe thesareve të tjera të së kaluarës në të qenit zona të arsimimit dhe edukimit joformal. Muzetë që synojmë sot janë të përbërë nga biblioteka, mjedise për zhvillimin

projekteve, galeri arti dhe salla ekspozimi dhe janë institucione të pajisura me teknika të prezentimit që nuk trajtojnë vetëm një dhe dy dimensione, por dhe pesë dimensione dhe që shndërrohen në hapësira të edukimit që pasurojnë jetën shoqërore<sup>6</sup>. Digjitalizimi i koleksioneve dhe mënyrat inovative të transmetimit të informacionit tek vizitorët, mbeten poashtu qështje të prioritizuara shkencërisht sa i përket reformimit të muzeve<sup>7</sup> në kohën kur është ndërmarrë ky hulumtim.

Marrë për bazë që në kontekst të institucioneve muzeale të Republikës së Kosovës në përgjithësi, dhe të atyre në rajonin e Prizrenit në veçanti, gjejmë pak informacion se cilat janë problemet dhe mangësitë të cilat e karakterizojnë gjendjen ekzistuese të tyre, dhe poashtu, se cilat mund të jenë parashikimet dhe përkushtimet afatshkurtëra dhe afatgjata lidhur me të ardhmen e këtyre institucioneve, ky hulumtim mëton që të kontribuoj në një proces të rëndësishëm, atë të dokumentimit dhe analizës së gjendjes ekzistuese të muzeve të qytetit të Prizrenit.

Vetëm Prizreni numëron shtatë muze ekzistues, prej të cilëve disa nuk janë fare funksional, disa funksionojnë vetëm në periudha të caktuara e të tjerët, edhe pse janë funksional, ose operojnë në mungesë të stafit, ose kanë nevoja substanciale lidhur me ri-dizajnimin e ekspozive dhe shërbimeve të cilat i ofrojnë.

<sup>5</sup> Jerliu, F., "Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturorë 2017 – 2027", Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2016


<sup>6</sup> Günay, B., "Museum concept from past to present and importance of museums as centers of art education", International Conference on New Horizons in Education INTE2012, 2012

<sup>7</sup> Navafreite, T., "Teaching in Cultural Environments", Digitalization in Museums - Chapter 27, Ed. Bille, T., Mignosa, A., Towse, R., 2020




Fig.1. Ilustrim i pesë institucioneve muzeale të përshira në hulumtim

Ky hulumtim trajton pesë muzetë kryesore të qytetit të Prizrenit, duke përfshirë: (1) Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (2) Muzeun Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (3) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (4) Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe (5) Muzen e Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja”. Për shkak të thellimit në aspektin funksional të vetë objekteve, ky hulumtim nuk trajton (6) Muzeun e Hapur Arkeologjik dhe poashtu për shkak të funksionalizimit tash së fundmi (pas përfundimit të analizës në terren) në hulumtim nuk është përfshirë (7) Muzeu i Nënës Terezë.









## **1. METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I HULUMTIMIT**

---

Ky hulumtim i ndërmarrë në pesë objektet kryesore të institucioneve muzeale të qytetit të Prizrenit ka për qëllim identifikimin e problemeve aktuale dhe potencialeve që këto objekte bartin sa i përket reprezentimit të trashëgimisë kulturore dhe vlerave shoqërore dhe njëkohësisht dokumentimin e thellësishëm të tyre sa i përket instrakturës fizike. Duke qenë se Prizreni njihet për bagazhin kulturor në përgjithësi, dhe atë të trashëgimisë kulturore në veçanti, hulumtimi mëton të depërtojë në analiza operacionale të këyre institucioneve për të parë më shumë lidhur me faktin se nëse këto muze janë duke tërhequr mjaftueshëm vizitorët, apo në rastin më ideal, nëse mund të i përgjigjen tendencave të kohës për reformimin tyre drejt institucioneve muzeale atraktive të kohës. Poashtu analiza shqyrton qasshmërinë e personave me aftësi të kufizuara në këto institucione.

Për të krijuar një pasqyrë mbi gjendjen ekzistuese të këtyre institucioneve, kjo analizë është bazuar fillimisht në hulumtimin e literaturës ekzistuese, të dhënave zyrtare, intervistave me zyrtar dhe vrojimit në terren të gjendjes ekzistuese. Poashtu janë realizuar dy fokus grupe me profesionistë të fushës si dhe me përfaqësues të komunitetit për të mësuar më shumë lidhur me problemet aktuale dhe perspektivat dhe propozimeve të grupeve të ndryshme të komunitetit lidhur me të ardhmen e këtyre muzeve. Njëkohësisht është zhvilluar një anketë me qytetarë për të krijuar dhe sensin e përgjithshëm të kënaqshmërisë nga ana e qytetarëve lidhur me shërbimeve e ofruara në këto institucione dhe interesimin që qytetarët kanë për t'i vizituar muzetë aktual të qytetit të Prizrenit.

## 2. PËRKUFIZIME MBI ZHVILLIMIN HISTORIK TË INSTITUCIONEVE MUZEALE, KATEGORIZIMET DHE KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE

### ZHVILLIMI HISTORIK I MUZEVE

Fjala "muze" shpesh sjell në mendje një pamje të një ndërtese. Megjithatë, ideja e muzeut si një lloj ndërtese, qëllimi kryesor i të cilit është 'komunikimi dhe ekspozimi' (ICOM), nuk daton si koncept i tillë krahasuar në historinë e hershme të zhvillimit të muzeve. Në fakt, në filltet e historisë së muzeve, fjala "muze" nuk vrente për një ndërtesë, por për një koleksion. Vetëm nga fundi i shekullit të tetëmbëdhjetë, kur u krijua ideja e muzeut dhe u ndërtua ndërtesa e parë e pavarur, me funksion të destinuar si muze, u krijua dhe një tipologji e re arkitekturore, ajo e objekteve muzeale, e cila mbeti deri në fillim të shekullit të njëzetë<sup>8</sup>.

Duke ekzaminuar etimologjinë e fjalës 'muze' gjejmë se si fjalë ajo vie nga greqishtja e lashtë, *Mouseion*, që nënkupton një vend të shenjtë dedikuar *Muses* – hyjnive mbrojtëse të arteve në mitologjinë greke<sup>9</sup>.

Në antikën e lashtë dallonim hapësira publike të cilat akomodonin koleksione të objekteve me vlera estetike, historike dhe të religjionit. Studiuesi i muzeologjisë në relacion me arkitekturën, Kali Tzortzi nga Universiteti i Patras në Greqi, përcakton se historia e muzeve besohet të fillojë me Muzeun e Aleksandrisë, themeluar nga Ptolemy Soter, në kohën kur Aleksandria ishte në fokus për zhvillimin e jetës intelektuale Helenistike. Në Renesansë, dallojmë një kalim të theksuar nga ekspozimi i artefakteve muzeale në hapësirë të hapur, në ekspozimin në hapësira private.

Në këtë periudhë në fokus ishin objektet dhe koleksionet të cilat jo vetëm paraqisnin vlerë të vjetërsisë dhe antikitetit, por ato të cilat bartnin edhe vlera estetike. Ndër muzetë e spikatur të kësaj periudhe, i cili bart edhe 'epitetin e muzeut të parë në Evropë' njihet Palazzo Medici në Firencë (1440)<sup>10</sup>.



Fig.2. Palazzo Medici, muzeu i parë në Evropë

Përderisa Renesansa shënonte një kalim nga hapësira publike e të ekspozuarit, në atë private, fundi i Shekullit të XVII-të dhe fillimi i XVIII-të, sjell kalimin e trendeve muzeale nga hapësirat private në ato të destinimit publik, përkatësisht universitetet, akademitë, kishat dhe manastiret. Sipas Tzortzit, Shekulli i XVIII-të sollti idenë e dizajnit të një objekti arkitektonik i cili në mënyrë të veçantë do të akomodonte koleksionet muzeale, ndërsa Shekulli i XIX-të shënoj themelimin e tipologjisë arkitektonike të objekteve muzeale, përmes ndërtimit të tri objekteve specifike muzeale, Muzeut Glyptotech në Munich (1816-30), Altes Museum në Berlin (1823 – 30) dhe muzeut Alte Pinakothek në Munich (1826 – 36)

<sup>8</sup> Tzortzi, K. "Museum Space – Where Architecture Meets Museology", Routledge, 2016, fq. 11-43

<sup>9</sup> Findlen, P., "The Museum: its classical etymology and renaissance genealogy". Journal of the History and Collection.(1), 1989, fq. 59-78

<sup>10</sup> Tzortzi, K. "Museum Space – Where Architecture Meets Museology", Routledge, 2016, fq. 11-43

<sup>11</sup> Ibid.



Fig.3. a. Muzeu Glyptotech në Munich,  
 b. Altes Museum në Berlin,  
 c. Alte Pinakothek në Munich



Shekulli i XX-të solli tendencat e modernizimit të konceptit të objekteve muzeale, dhe daljes përtej përcaktimeve tipologjike të tyre. Themelimi i Muzeut të Artit Modern në Neë York në vitin 1929 ishte ndër zhvillimet më të spikatura të këtij shekulli, sikunder dhe risitë dhe konceptet e reja arkitektonike që ndodhën në këtë shekull, siç ishte ndërtimi i Muzeut të

Guggenheimit në New York (1959) projektuar nga arkitekti me famë botërore, Frank Lloyd Ēright. Ndër zhvillimet e tjera teorike drejt reformimeve të institucioneve muzeale ishte tendenca e akirtektit modernist Ludëig Mies Van der Rohe, i cili e shihte muzeun 'më tepër një hapësirë për kenaqësi artistike se sa një hapësirë për izolimin e veprave të artit' .



Fig.4. Muzeu Guggenheim, New York

Fig.5. a.) Muzeu i Historisë së Natyrës, Los Angeles,  
 b.) Muzeu Arkeologjik, Izrael,  
 c.) Muzeu i Artit, Vienë



### KATEGORIZIMI I MUZEVE


Literatura njih disa modalitete të kategorizimit të institucioneve muzeale, edhe pse një kategorizim definitiv i kësaj tipologjie të objekteve kulturore është i vështirë të ipet në formë të prere dhe përfundimtare, duke qenë se llojet dhe menyrat e ekspozimeve (të përkohshme dhe të përhershme) janë përherë subjekt i ndryshimit, marrë për bazë dhe zhvillimet e fundit, sipas të cilave muzetë migrojnë nga koncepti tradicional, vetëm i ruajtjes dhe ekspozimit të koleksioneve muzeale, në hapësira interaktive dhe përherë në ndryshim. Megjithatë, historikisht, bazuar në kumtesën e lexuar në takimin e Asociacionit të Muzeve në Newcastle – on – Tyne, në Londër (23 Korrik 1895) , institucionet muzeale mund të ndahen sipas dy mënyrave:

a. Sipas llojit të përmbajtjes/ koleksionit:

- A. Muzeu i arteve
- B. Muzeu i historisë
- C. Muzeu i antropologjisë
- D. Muzeu i historisë së natyrës
- E. Muzeu i teknologjisë
- F. Muzeu i zhvillimit ekonomik

b. Sipas qëllimit në bazë të të cilit janë themeluar:

- A. Muzeu kombëtar
- B. Muzetë lokal, muzeu i qytetit apo provincës
- C. Muzeu i shkollës apo universitetit
- D. Muzeu profesional
- E. Muzetë e specializuara të një lëmie të caktuar të studimit, të zotuar nga individ apo shoqata



Në tipe të tjera të muzeve literatura e gjerë poashtu liston: muzetë arkitekturore, muzetë arkeologjike, muzetë e artit, muzetë e automobilave, muzetë e dizajnit, muzetë e fëmijëve, muzetë etnologjike/etnografike, muzetë ushtarake dhe të luftës, muzetë e shkencës, muzetë vizuale etj.

<sup>13</sup> Goode, G.B., "On the Classification of Museums", Vol. 3, No. 57 (Jan. 31, 1896), fq. 154-161



## KARAKTERISTIKAT FUNKSIONALE

Përmbajtjet e hapësirave funksionale janë përgjithësisht të njëjta në të gjitha llojet e muzeve, duke filluar nga holli hyrës, hapësira pritëse dhe informuese, hapësirat ekspozuese të karakterit të përkohshëm dhe të përhershëm, deponia e ruajtjes së koleksioneve, hapësira e konzervimit dhe restaurimit dhe njësitë administrative. Me qëllim të ruajtjes së sigurisë së ekspozateve, është e rëndësishme një ndarje vitale e hapësirave në grupacione si vijon<sup>14</sup>:

- Hyrja, informatat, dyqan i suvenireve, kafene, toalete dhe garderoba
- Ekspozita e përhershme dhe e përkohshme
- Hapësirat për edukim, salla e ligjeratave dhe hapësirat për studim/hulumtim
- Zyret: administrative, kuratoriale, të konservizimit, të dizajnit etj.
- Punëtoritë për konzervim, labororet, paisjet e përpunimit të materialeve digjitale
- Depo e ruajtjes së koleksionit, hapësirat e sigurimit dhe inspektimit
- Mirëmbajtja e koleksionit të ekspozitës dhe punëtorive

Ajo që është e rëndësishme në definimin funksional të muzeve, që në fillim të projektimit të tyre, është përcaktimi i tipologjisë së rrugëtimit që publiku, apo shfrytëzuesit e jashtëm do të përdorin me qëllim të frekuentimit të hapësirave ekspozuese, hapësirave për edukim dhe hapësirave të tjera që krijojnë interaksion. Lidhur me këtë ekzistojnë disa tipologji të sekuencave të cilat vizitorët mund të ndjekin në një objekt muzeal: (a) i hapur, (b) qendror dhe me kthina anësore, (c) linear, (d) rrethor, (e) kompleks dhe (f) në formë labirinthi<sup>15</sup>.

Varësisht nga lloji i muzeve dhe kategoria e koleksioneve, elementet ekspozuese mund të ekspozohen në modalitete të ndryshme, duke variuar nga elementet e varura në mur apo sipërfaqe anësore (a, b, c), elementet të cilat qëndrojnë në mënyrë të pavarur (d, e), elementet e vendosura në korniza ekspozuese (f, g, h). Muzetë bashkëkohorë kanë integruar tashmë edhe modalitete të ekspozimit multimedial<sup>16</sup>.

Faktor tjerë të rëndësishëm në përcaktimin e kornizës funksionale të muzeve janë: kontrollimi i lagështisë, kontrollimi i pastërtisë së ajrit, ndriqimi dhe zërimi adekuat si dhe kontrollimi i sigurisë.

<sup>14</sup> Ed.David Littlefield, "Metric Handbook – Planning and Design Data, Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 - 455

<sup>15</sup> Ibid.

<sup>16</sup> Ibid.








Fig.7. Modalitetet bazike të ekspozimit.

## ADMINISTRIMI

Nuk ka një model saktësisht të përcaktuar për administrimin e përgjithshëm të muzeve në mbarë botën. Mungesa e një modeli të tillë derivon nga diversiteti i koleksioneve të muzeve, por gjithashtu pasqyron një ambivalencë në të kuptuarit e rolit të muzeve në shoqëri, varësisht nëse muzetë janë ekspozues dhe interpretues të trashëgimisë kulturore, depozitorë të eksponateve me vlerë lidhur me historinë njerëzore dhe natyrore, instrumente për interaksion social në zhvillimin e një shoqërie apo vetëm hapësira për rekreim dhe kalim të kohës së lirë<sup>17</sup>.

Në Kosovë, përpos insitucioneve muzeale të cilat funksionojnë si insitucione të veçanta kulturore, siç është Muzeu Kombëtar i Kosovës, një numër i konsiderueshëm i muzeve lokale menaxhohet nga Qendrat Rajonale të

Megjithatë rastet e muzeve të cilat janë nën menaxhimin e insitucioneve vartëse të MKRS-së, përkatësisht Institutit Arkeologjik të Kosovës si dhe të organeve të nivelit lokal, siç janë drejtoritë komunale të kulturës dhe turizmit, nuk përjashtohen.

Ndërkombëtarisht menaxhimi i muzeve kryesisht bëhet nga niveli qendror, nga i cili buron edhe korniza ligjore e udhëheqjes së muzeve, të cilat përveç tjerash paraqesin pasuri shtetërore. Administrimi i muzeve kërkon trupë udhëheqëse që në vete përmban specialist me njohuri për koleksionet, koleksionues, studiues, laborantë, dizajnerë, njohës të marrëdhëneve me publikun, zyrtarë të sigurisë etj<sup>18</sup>.

---


<sup>17</sup> Brittanica, "Museums Structure and Operation", qasur në Nëntor, 2022  
<https://www.britannica.com/topic/museum-cultural-institution/Museum-structure-and-operations>


<sup>18</sup> Ibid.


## QASSHMËRIA


Arritja e qasshmërisë së plotë në institucionet muzeale është një mision i përcaktuar dhe zhvilluar tashmë ndërkombëtarisht. Mirëpo, hulumtimet e ndryshme dëshmojnë se personat me aftësi të kufizuara ende në të shumtën e rasteve rezultojnë të jenë të privuar në qasshmërinë e tyre në institucionet kulturore, siç janë muzetë<sup>19</sup>.


Në mënyrë që institucionet muzeale të jenë të qasshme për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, muzetë duhet të ndërmarrin nisma për adaptimin e tyre për qasshmëri të plotë, duke u nisur nga eliminimi i barrierave fizike në objekte, por poashtu edhe në shërbimet që ato ofrojnë. Më konkretisht, nismat të cilat rekomandohen janë:

 —Për të verbërit dhe personat me shikim të dobësuar duhet të sigurohen pllaka taktile, shkallë të përshtatshme për lëvizje dhe të pajisura me doreza dhe shenjësues, audio informues dhe shënime informuese në alfabetin e Brail-it.

 —Për të shurdhërit dhe personat me dëgjim të dobësuar duhet të sigurohen paisje për asistencë në dëgjim dhe interpretim vizuel.

 —Për personat me aftësi të kufizuara fizike duhet të sigurohen pulte informuese të ulëta dhe të dimensionuara për nevojat e personave në karrocë, karroca lëvizëse ndihmëse, rampa dhe ashensorë, hapësira të dimensionuara në mënyrë të tillë që mundësojnë lëvizjen e personave në karrocë.

 —Për personat me dëmtim kognitiv duhet të ofrohen piktograme univerzale

 —Për personat me autizëm duhet të ofrohen hapësira të qeta

Në Kosovë, qasshmëria në institucionet muzeale, duke qenë se ato i takojnë spektrit të institucioneve publike, duhet të rregullohet bazuar në Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara<sup>20</sup>.



Fig.8. Raste të qasshmërisë në muzetë botërore:  
a. përdorimi i alfabetit të Brail-it; b. qasshmëria fizike pa barriera

<sup>19</sup> Montsho, G., "Making Museums Accessible to Those With Disabilities", Museum Next, 2022, qasur në Nëntor, 2022 <https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-those-with-disabilities/>

<sup>20</sup> EC Ma Ndryshe, "Udhëzim Administrativ - për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara", 2016, qasur në Nëntor, 2022, [https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153\\_udhezimi\\_administrativ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf)









### 3. INSTITUCIONET MUZEALE NË KOSOVË

Institucionet muzeale në Republikën e Kosovës ekzistojnë në numër të konsiderueshëm, përkundër faktit të mungesës të statistikave apo një database shtetërore lidhur me numrin e tyre, llojin e eksponeve, vendndodhjen gjeografike dhe numrin e vizitorëve.

Në rradhën e muzeve më dominant në gamën e institucioneve muzeale të Kosovës padyshim mund të klasifikohet Muzeu Kombëtar i Kosovës si një ndër objektet më të vjetra kulturore dhe historike në Kosovë (1949)<sup>(21)</sup>.

Përpos Muzeut Kombëtar, i cili për qëllim ka ruajtjen, mbrojtjen dhe promovimin e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës, në të gjitha qendrat më të mëdha administrative të Kosovës operojnë muzetë e qyteteve. Këta të fundit variojnë për nga kategorizimi, duke funksionuar kryesisht si muze të përgjithshëm rajonal, muze të historisë, muze etnologjik dhe muze arkeologjik.



← Fig.9. Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë.



Fig.10 a.) Muzeu Etnologjik në Pejë,  
b.) Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit  
c.) Muzeu i qytetit të Ferizajit,  
d.) Muzeu i qytetit të Mitrovicës,  
e.) Muzeu Etnografik i Gjakovës,  
f.) Muzeu Rajonal i Gjilanit.









#### **4. INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË PRIZRENIT**

---

Qyteti i Prizrenit numëron gjithsejt shtatë muze: (1) Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (2) Muzeun Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (3) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (4) Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe (5) Muzeun e Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja”, (6) Muzeun e Hapur Arkeologjik dhe (7) Muzeu i Nënës Terezë.

Institucionet muzeale të Prizrenit prezantojnë, ruajnë dhe koleksionojnë koleksione nga qyteti dhe rajoni i Prizrenit, ndërsa për nga fushëveprimi dominojnë muzetë e historisë, arkeologjisë dhe etnologjisë.


Bazuar në hulumtimin fillestar të inicuar në kuadër të kësaj analize, është vërtetuar se nga shtatë muzetë ekzistues të qytetit të Prizrenit, vetëm dy prej tyre operojnë në baza të rregullta ditore, respektivisht: Muzeu i Lidhjes Shqiptarë të Prizrenit dhe Muzeu Arkeologjik – Hamami i Shemsedin Beut dhe Sahatkulla. Tri institucionet tjera muzeale, Muzeu Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, Muzeu i Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja” dhe Muzeu i Kalasë së Prizrenit janë të hapur vetëm me dakordim paraprak. Muzeu i Nënës Terezë ka rezultuar të jetë i qasshëm vetëm në momentin e ditëve inauguruese, ndërsa Muzeu i Hapur Arkeologjik, bazuar dhe në karakterin që bart, është i hapur për publikun në mënyrë permanente.



Fig. 11. Muzetë aktual të qytetit të Prizrenit:  
 (a) Muzeu i Kalasë së Prizrenit,  
 (b) Muzeu Arkeologjik –  
 Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla,  
 (c) Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit,  
 (d) Muzeu i Hapur Arkeologjik,  
 (e) Muzeu i Nënës Terezë,  
 (f) Muzeu Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, dhe  
 (g) Muzeu i Elektranës – Hidroelektrana “Prizrenasja”.







24 Fig. 12. Hartëzimi i institucioneve muzeal të përfshira në hulumtim.





- MUZE TË MBYLLUR PËR VIZITORË
- MUZE TË HAPUR PËR VIZITORË
- MUZE TË HAPUR PËR VIZITORË
- VETËM NË RASTE TË CAKTUARA

#### 4.1. GJENDJA EKZISTUESE FIZIKE

Ky hulumtim trajton pesë muzetë kryesore të qytetit të Prizrenit, duke përfshirë: (1) Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (2) Muzeun Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (3) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (4) Muzeun e Kalasë së Prizrenit dhe (5) Muzeun e Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja”. Për shkak të thellimit në aspektin funksional të vetë objekteve, ky hulumtim nuk trajton (6) Muzeun e Hapur Arkeologjik dhe poashtu për shkak të funksionalizimit tash së fundmi (pas përfundimit të analizës në terren) në hulumtim nuk është përfshirë (7) Muzeu i Nënës Terezë.

Të gjitha muzetë e qytetit të Prizrenit operojnë në objekte arkitektonike në gjendje të mirë fizike, të cilat, përpos dy muzeve të inaugurara së fundmi, Muzeut të Kalasë dhe Muzeut të Nënës Terezë, të gjitha veprojnë në objekte të trashëgimisë kulturore.

#### KUFIRI I QENDRËS HISTORIKE TË PRIZRENIT


L  
I  
S  
T  
A  
E  
M  
U  
Z  
E  
V  
E

1. MUZEU ARKEOLOGJIK - HAMAMI I SHEMSIDIN BEUT DHE SAHATKULLA
2. MUZEU ETNOLOGJIK - SHTËPIA E SHEHZADES
3. MUZEU I KOMPLEKSIT TË LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT
4. MUZEU I KALASË SË PRIZRENIT
5. MUZEU I ELEKTROEKONOMISË - HIDROELEKTRANA “PRIZRENASJA”

5

0 50 100 200 400m





Hamami i Shemsedin Ahmet Beut dhe Sahat Kulla gjenden në pjesën perëndimore të qytetit të vjetër. Hamami është ndërtuar në shekullin XV, përkatësisht në vitin 1498. Nuk dihet se deri në cilin vit është përdorur si hamam, por dihet se hamami nuk ka kryer funksionin e tij që nga mesi i shek. XIX kur mbi hapësirën e ngrohtë të Hamamit është ndërtuar Sahat Kulla. Në fund të viteve 60' dhe në fillim të viteve 70' të shekullit XX në Rajonin e Prizrenit, kryesisht në rrjedhën e Drinit të Bardhë u zbuluan shumë lokalitete arkeologjike, u zhvilluan shumë ekspedita gjurmuese nga të cilat u zbulua një material shumë i pasur arkeologjik e të cilat u vendosën në objektin e trashëgimisë kulturore të Hamamit të Shemsedin Beut dhe të Sahat Kullës.

**>MUZEU ARKEOLOGJIK-  
HAMAMI I SHEMSEDIN  
BEUT DHE SAHATKULLA<**

Muzeu trajton materialin arkeologjik nga lokalitete arkeologjike të Rajonit të Prizrenit, gjegjësisht nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Rahovecit, Malishevës dhe Suharekës. Materiali i ekspozuar prezanton një periudhë të gjerë kohore të artefakteve, që nga Neoliti, Eneoliti, Periudha e Bronzit, Periudha e hekurit, Periudha Antike e Romake, Mesjeta dhe Periudha Osmane. Monumenti është një kompozicion i veçantë arkitektonik gërshetimi i Hamamit së bashku me Sahat Kullën, dhe vendosja këtu e muzeut arkeologjik, është rast unik që nuk gjendet diku tjetër. Hamami i Shemsedin Ahmet Beut është ndër hamamet më të vjetra të Ballkanit dhe së bashku me Sahat Kullën përbëjnë ndër objektet më interesante dhe karakteristike të qytetit të Prizrenit<sup>22</sup>.



Muzeu Etnologjik i Prizrenit operon në shtëpinë tradicionale të qytetit të Prizrenit, e njohur si Shtëpia e Shehzades. Shtëpia e Musa-Efendi Shehzades gjendet në pjesën rrafshinore të qytetit në rrugën e "Sarajit të Vjetër" dhe është ndërtuar në fund të shek. XVIII. Është objekt banimi i tipit rrafshinor, i ngritur në kate. I takon objekteve jo simetrike. Objekti është i pasur me elemente etnografike në enterier. Vlen të theksohen oxhaqet e përpunuara që gjenden një në përdhese dhe dy në kate. Edhe drugdhendja është e pasur

#### >MUZEU ETNOLOGJIK-SHTËPIA E SHEHZADES<

sidomos përpunimi i tavaneve ("Xhyl-tavan"), dollapëve, musëndrave etj. Në fasadën kryesore që gjendet në anën lindore janë punuar timpanore prej druri që janë karakteristike edhe për disa shtëpi tjera të qytetit të Prizrenit. Pas viteve '80 të shek. XX objekti nuk shfrytëzohet për banim ndërsa së fundmi në të zhvillon aktivitetin e vet Muzeu Etnologjik<sup>23</sup>. prezenton koleksionin etnologjik të veshjeve të ndryshme tradicionale dhe eksponateve numizmatike të shqiptarëve të Prizrenit, dhe komunitetit goran të regjionit të Opojës<sup>24</sup>.


<sup>23</sup> "Monuments of Albania", qasur në Dhjetor 2022, <https://www.facebook.com/1531035643804187/photos/a.1531541350420283/2672133033027770/>  
<sup>24</sup> EC Ma Ndryshe, "Prizreni 'qytet muze' pa muze?", Maj 2008, qasur në Nëntor 2022, <https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530>



Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit është një kompleks muzeor dhe monument i trashëgimisë kulturore në qytetin historik të Prizrenit. Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, si tërësi urbanistike dhe arkitektonike në aspektin hapësinor shtrihet në bërthamën e vjetër të qytetit të Prizrenit dhe ka vlerë të veçantë kulturore, historike, arsimore, shoqërore dhe ambientale. Në kuadër të Kompleksit ndodhen Ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit, Muzeu, Biblioteka dhe Leximorja, Galeria e Arteve, Medreseja, Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Tyrbeja si dhe objektet e banimit. Në këtë Kompleks është mbajtur Lidhja e Prizrenit - një organizim politik i vilajeteve shqiptare me 10 qershor, 1878 e që si qëllim kishte

### >MUZEU I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT<

mbrojtjen e territoreve shqiptare ng aneksimi i shteteve fqinjëve dhe bashkimin e shqiptarëve në një vilajet autonom. Në vitin 1968 për arsye të ndërtimit të rrugës bëhet rrënimi i objekteve buzë lumit derisa vetëm ndërtesa e Rezidencës Qeveritare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dislokohet për disa metra në perëndim. Edhe në vitet 1976/78 bëhen ndërhyrje të rëndësishme duke rrënuar disa objekte të Kompleksit të Gaz Mehmed Pashës për të formuar Muzeun e Lidhjes së Prizrenit për nder të 100 vjetorit të saj. Gjatë luftës së fundit në vitin 1999 digjet tërësisht ndërtesa e Rezidencës Qeveritare të Lidhjes së Prizrenit e cila rindërtohet në qershor të vitit 2000<sup>25</sup>.



Muzeu i Kalasë është themeluar në vitin 2016, në lokalitetin Arkeologjik të Kalasë. Gjetjet e ndryshme të periudhave të ndryshme historike që janë zbuluara gjatë gërmimeve në kala dhe për rreth zonës janë vendosur në këtë muze, i cili bartë karakterin e një muzeu me ekspozitë të përhershme<sup>26</sup>. Kalaja e Prizrenit konsiderohet të jetë simboli i qytetit të Prizrenit dhe një element me rëndësi në identitetin kulturor të Kosovës. Ajo përmban në vete një pjesë të rëndësishme të historisë së lashtë të qytetit. Pozicioni i saj topografik, dominues mbi qytetin, peizazhi natyror mjaft tërheqës dhe konfigurimi arkitektonik i menduar mjaft mirë e bëjnë këtë objekt me vlera të padiskutueshme arkeologjike, historike dhe

### >MUZEU I KALASË SË PRIZRENIT<


turistike. Muret fortifikuese ndjekin izohipset e terrenit duke rrethuar një sipërfaqe rreth 1.5 ha në trajte përafërsisht vezake me zgjatje veri-jug<sup>27</sup>. Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike të bëra në vitet 2004 dhe 2009, 2010 dhe 2011 dha rezultate shtesë të cilat ndikuan dhe në themelimin e Muzeut të Kalasë. Për herë të parë u dokumentuan dëshmi të një vendbanimi parahistorik të datuar paraprakisht në epokën e bronzit dhe periudhën e hershëm të hekurit i cili ka shërbyer si bërthama e parë e jetës në këtë vend. Po ashtu për herë të parë këto gërmime dhanë gjurmë të arkitekturës dhe dëshmi të materialit të datueshëm në periudhën romake dhe antikën e vonë<sup>28</sup>.

<sup>26</sup> "Muzeu i Kalasë i gatshëm për vizitorë", Kallxo.com, qasur në Dhjetor 2022, <https://kallxo.com/shkurt/muzeu-ne-kalane-e-prizrenit-i-gatshem-per-vizitore/>

<sup>27</sup> Mehmet, K., "Fjalori Enciklopedik i Kosovës". Vëll. 1. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. fq. 744 – 745, 2018

<sup>28</sup> Gëzim H., "Të dhëna të reja arkeologjike nga Kalaja e Prizrenit / Nouvelles données archéologiques sur la forteresse de Prizren". Iliria (në frëngjisht dhe shqip), qasur në Djetor 2022, [https://www.persee.fr/doc/iliri\\_1727-2548\\_2007\\_num\\_33\\_1\\_1073](https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_2007_num_33_1_1073)





Muzeu i Elektroekonomisë së Kosovës i njohur në fillimet e tij si "Hidroelektrana Prizrenasja" është një monument i trashëgimisë kulturore në Prizren. Objekti i Muzeut të Elektroekonomisë së Kosovës apo Hidroelektrana "Prizrenasja" gjendet në ambientin piktoresk të Grykës së Lumbardhit, 2.5 km larg Prizrenit. Është ndërtuar në vitin 1926-28 me kontributin e qytetarëve dhe kredive bankare. Ndërtesa është projektuar dhe ndërtuar nga një kompani austriake nga Vjena. Objekti ka pasur elementet moderne të asaj kohe: turbinat e ujit, pjesën për pastrimin e ujit nga mbeturinat, kanalën, pajisjet për përcjelljen e ujit gjer në turbinë dhe gjeneratorin me fuqi 160 KW.

**>MUZEU I ELEKTRO-  
EKONOMISË -  
HIDROELEKTRANA  
"PRIZRENASJA"<**

Për shkak të kërkesës së madhe të energjisë elektrike në vitin 1936 është lëshuar në qarkullim gjeneratori i dytë me kapacitet të njëjtë. Në vitin 1979 kjo ndërtesë e rëndësishme për historinë industriale të qytetit është shndërruar në Muze të Energjisë Elektrike të Kosovës. Muzeu ka funksionuar deri në mes të viteve të 80'tatë shekullit të kaluar. Pas një periudhe të gjatë të mungesës së mirëmbajtjes, në vitin 2011 objekti është restauruar. Muzeu i Energjisë Elektrike i vendosur në një ndërtesë historike "Hidroelektranë" paraqet një shembull unik për Kosovën, për trajtimin e objekteve industriale si trashëgimi kulturore<sup>29</sup>.



#### **4.2. OPERIMI, KAPACITETET NJERËZORE DHE SHËRBIMET E OFRUARA**

Muzetë e analizuar në kuadër të këtij hulumtimi rezultojnë të jenë të menaxhuara nga nivell qendror dhe ai lokal. Më konkretisht Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Muzeu Etnologjik dhe Muzeu i Elektranës janë nën menaxhimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturorë. Muzeu Etnologjik është nën menaxhimin lokal, përkatësisht të Komunës së Prizrenit, ndërsa Muzeu i Kalasë menaxhohet nga Instituti Arkeologjik i Kosovës, si institucion vartës i MKRS-së.

Me qëllim të krijimit të një databaze lidhur me numrin dhe llojin e eksponateve, stafin aktual dhe shërbimet e ofruara aktualisht, në kuadër të këtij hulumtimi janë adresuar shkresa zyrtare në secilin nga institucionet që menaxhojnë muzetë në fjalë. Bazuar në të dhënat e pranuar me shkrim, dhe poashtu në vrojtimit dhe analizat në terren nga ana e hulumtuesve, janë përpiluar kartelat informuese si më poshtë.



Emërtimi:	Hamami i Shemsedin Beut dhe Sahatkulla
Viti i themelimit:	1975
Kategoria:	Muze arkeologjik
Administrimi:	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë
Sipërfaqja e parcellës:	568 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e objektit:	386.5 m <sup>2</sup>
Modaliteti i operimit:	I hapur për vizitorë
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Gusht 2022:	800 vizitorë
Numri dhe lloji i eksponateve:	Numri i eksponateve në Muzeun Arkeologjik është 874 artefakte prej të cilave: Në vitrina ekspozuese - 874; Jashtë vitrinave ekspozuese, në ambient të brendshëm - 30 Në hapësirën e epsozitive të përkohshme - 22 Në oborrin e muzeut – 22 Të pa ekspozuara - 24
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar:	1 arkeolog 1 roje
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Jo
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po
A posedon shenjzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Jo
A ofron interpretues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Pjesërisht

Emërtimi:	Shtëpia e Shehzades
Viti i themelimit:	2013
Kategoria:	Muze etnologjik/ etnografik
Administrimi:	Komuna e Prizrenit, Drejtoria për Kulturë, Drejtoria për Turizëm, OJQ "Numizmatika"
Sipërfaja e parcellës:	370 m2
Sipërfaqja e objektit:	404 m2
Modaliteti i operimit:	I hapur për vizitorë vetëm me lajmërim paraprak
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Gusht 2022:	300 vizitorë
Numri dhe lloji i eksponateve:	Eksponatet i përkasin fillimit të Shek.XX – dhe gjysmës së dytë të Shek.XX, dhe përfshijnë: tekstile të endura prej leshi nga fshatrat e Regjionit të Prizrenit, çilima nga leshi dhe mëndafshi, çarçafe, enë bakri, mangalla, vathë grash, gjerdana, kësule nuseje, aksesore për qostek, zbukurues të ndryshëm muri, përparëse të ndryshme 'bohqe', enë të ndryshme prej bakri, arka të ndryshme, breza të ndryshme grash prej argjendi dhe të praruara në flori, këmisha të ndryshme grash dhe burrash të endura në pëlhurë, çorape të ndryshme, kuti postare të ndryshme, këmisha me ornamente, rrethore për pushkë, veshje të ndryshme, këllëfa për jastëqe, gjanadana për gra dhe meshkuj etj.
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar:	3 (nuk ka informata mbi profilet profesionale të stafit të angazhuar)
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Jo
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po
A posedon shenjzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Jo
A ofron interpretues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Jo

Emërtimi:	Kompleksi i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit
Viti i themelimit:	1968 - 1878
Kategoria:	Muze historik
Administrimi:	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë
Sipërfaqja e parcellës:	1402.3m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e objektit:	686 m <sup>2</sup>
Modaliteti i operimit:	I hapur për vizitorë
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Gusht 2022:	7000 vizitorë
Numri dhe lloji i eksponateve:	Numri i eksponateve në Kompleksin e LSHP-së është 968 artefakte/ eksponate, prej të cilave:  Sektori i historisë - 264; Sektori i etnografisë - 603 Sektori i galerisë së arteve - 98
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar:	1 historian, 1 kurator-grafist, 2 etnologe, 4 roje, 1 pastruese
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Jo
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po
A posedon shenjzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Jo
A ofron interpretues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Jo



Emërtimi:	Muzeu i Kalasë
Viti i themelimit:	2016 - 2019
Kategoria:	Muze arkeologjik
Administrimi:	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Instituti Arkeologjik i Kosovës
Sipërfaqja e parcellës:	15970 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e objektit:	652.12 m <sup>2</sup>
Modaliteti i operimit:	I hapur për vizitorë vetëm me lajmërim paraprak
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Gusht 2022:	200 vizitorë
Numri dhe lloji i eksponateve:	Numri i eksponateve 280 – ekspozita përmban materiale të rajonit, jo vetëm të Kalasë, nga koha e Nelotitit të Hershëm
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar:	1 roje
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Jo
A ofron shërbime të ciceronëve?	Po
A posedon shenjzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Po
A ofron interpretues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Muzeu ofron qasje për personat me aftësi të kufizuara, mirëpo infrastruktura për të arritur deri tek muzeu, respektivisht rruga për në Kompleksin e Kalasë është e pa qasshme.

Emërtimi:	Muzen e Elektroekonomisë – Hidroeletrana “Prizrenasja”
Viti i themelimit:	1979
Kategoria:	Muze ekonomik
Administrimi:	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit; Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë
Sipërfaqja e parcellës:	568 m <sup>2</sup>
Sipërfaqja e objektit:	170 m <sup>2</sup>
Modaliteti i operimit:	I hapur për vizitorë vetëm me lajmërim paraprak
Numri i vizitorëve në periudhën Janar – Gusht 2022:	200 vizitorë
Numri dhe lloji i eksponateve:	Muzeu i Hidroelektranes “Preizrenasja” ka të ekspozuar vetëm pjesë të makinerive të kohës kur ka funksionuar si hidroelektranë, dhe disa pjesë të sistemit elektrik në oborr. Nuk ka listë të artefakteve.
Numri dhe profilet e stafit të angazhuar:	1 roje
A posedon kalendar vjetor të ngjarjeve dhe aktiviteteve?	Jo
A ofron shërbime të ciceronëve?	Jo
A posedon shenjzues dhe informues lidhur me eksponatet e ekspozuara dhe ekspozitën në përgjithësi?	Jo
A ofron interpretues për personat e shurdhër (përmes gjuhës së shenjave) dhe të verbër (përmes shënimeve në alfabetin e Brail-it)?	Jo
A ofron qasje për Personat me Aftësi të Kufizuara?	Jo

### 4.3. ANALIZA E HAPËSIRAVE DHE SEKUENCAT E LËVIZJEVE

Me qëllim të analizës së hapësirave fizike të institucioneve muzeale të përzgjedhura në kuadër të këtij hulumtimi, karakteristikave hapësinore që ato bartin dhe identifikimit të mangësive potenciale në organizimin funksional dhe poashtu në kushtet tjera të cilat muzetë duhet t'i përmbushin (të specifikuar në kapitullin 3), është bërë analiza e tipologjive të hapësirave ekspozuese në raport me sekuencat e lëvizjes së vizitorëve.

Është karakteristike për faktin që të gjithë muzetë aktual paraqesin tipologji të ndryshme të hapësirave ekspozuese, dhe është e vështirë të pozicionohen në një rën ndër tipologjitë e përcaktuara në kuadër të normativave të projektimit të objekteve muzeale. Kjo derivon edhe nga fakti se shumica prej këtyre muzeve (në përjashtim të Muzeut të Kalasë) është përcaktuar të operojnë në kuadër të objekteve ekzistuese të trashëgimisë kulturore, dhe jo të projektuara fillimisht për të patur këtë destinim (siç është Muzeu i Kalasë).

Sekuencat jo qartë të definuara të lëvizjes së vizitorëve paraqesin mangësi në funksionimin e vet muzeve, mangësi të cilat janë identifikuar në shtojcën grafike të kësaj analize.


Përpos analizave në tipologjitë e hapësirave, thellësinë e tyre dhe shtrirjen funksionale të objekteve muzeale të bëra në gjendjen ekzistuese, në kuadër të këtij hulumtimi është bërë edhe analiza e lëvizshmërisë së vizitorëve. Duke qenë se vetëm dy nga pesë muzetë e analizuar janë të qasshëm për vizitorët në baza të rregullta (përderisa muzetë e tjera janë pjesërisht të mbyllur, dhe hepen vetëm në periudha të caktuara të vitit siç është Muzeu i Kalasë apo me dakordancë përprake, siç janë Muzeu Etnologjik dhe Muzeu i Elektroekonomisë), analiza në lëvizshmërinë e vizitorëve është bërë vetëm në Muzeun Arkeologjik dhe Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.

Numërimet dhe përcjellja e vizitorëve është bërë në intervale kohore një orëshe, në tri periudha të ndryshme të ditës (11:00-12:00; 13:00-14:00; dhe 15:00-16:00). Të gjeturat mbi statistikën e vizitorëve në këto periudha kohore, trajektoren e lëvizshmërisë së tyre dhe identifikimin e hapësirave me më së shumti interes për tu vizituar nga ana e vizitorëve janë prezentuar në ilustrimet e mëposhtme dhe poashtu, në mënyrë më të detajuar, në shtojcë.



<p><b>MUZEU ARKEOLOGJIK</b></p>	<p>A - Hapësirat që lidhen me 1 hapësirë tjetër  B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera  C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera  D - Hapësira që lidhen me komunikim vertikal</p>	<p><b>Kompleks</b></p>
<p><b>MUZEU ETNOLOGJIK</b></p>	<p>SKEMA E PËRDHESËS:  SKEMA E KATIT 1:</p> <p>A - Hapësirat që lidhen me vetëm 1 hapësirë tjetër  B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera  C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera  D - Hapësirat që lidhen me komunikim vertikal</p>	<p><b>Qëndror</b></p>
<p><b>MUZEU I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT</b></p>	<p>Skema e ndërtesës së LDKP:  Skema e ndërtesës së medrasave:</p> <p>A - Hapësirat që lidhen me vetëm 1 hapësirë tjetër  B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera  C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera  D - Hapësirat që lidhen me komunikim vertikal</p>	<p><b>Linear &amp; Kompleks</b></p>
<p><b>MUZEU I KALASË</b></p>	<p>A - Hapësirat që lidhen me 1 hapësirë tjetër  X - Hapësirat që nuk lidhen me asnjë hapësirë tjetër</p>	<p><b>Kompleks</b></p>
<p><b>MUZEU I HIDROELEKTRANËS</b></p>	<p>A - Hapësira që lidhet me 1 hapësirë tjetër  B - Hapësira që lidhet me 1 hapësirë tjetër dhe stimulon këthimin prapa</p>	<p><b>Linear</b></p>

Fig. 13. Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Prizrenit në relacion me lëvizjen e vizitorëve



ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE



ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE

Fig. 14. Sekuencat e lëvizjes në: a.) Muzeun Arkeologjik, Për më shumë, në shtojcën e hulumtimit




Fig. 14. Sekuencat e lëvizjes në: b.) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për më shumë, në shtojcën e hulumtimit




#### 4.4. QASSHMËRIA E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Bazuar në përcaktimet e dhëna në Udhëzimin Administrativ për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe në krahasueshmëri me rekomandimet ndërkombëtare mbi qasshmërinë gjithëpërfshirëse në institucionet muzeale, kjo analizë nxjerr të dhëna për faktin që asnjë nga muzetë e analizuar nuk rezultojnë të jenë të qasshme dhe në dispozicion për personat me aftësi të kufizuara.

Më konkretisht, asnjëri nga muzetë nuk ofron shërbime vizuale dhe asistencë në interpretim për personat e shurdhër dhe me pengesa në dëgjim. Asnjëri nga muzetë nuk ofron sqarime të ekspozitave në alfabetin e Brail-it. Poashtu, asnjëri nga muzetë nuk ofron asistencë për personat me dëmtim kognitiv dhe me autizëm.

Lidhur me aksesueshmërinë fizike, muzetë e analizuara rezultojnë të jenë të pa qasshme, duke patur pengesa dhe barriera të theksuara fizike. Pengesat e përgjithshme konsistojnë në mungesën e rampave, platformave dhe ashensorëve për komunikim vertikal si dhe poashtu mungesën e toaleteve për PAK. Ndërsa në veçanti janë identifikuar këto barriera dhe pengesa fizike:

- Në Muzeun Etnologjik materiali i dyshëmës së oborrit e pamundëson lëvizjen e personave me karrocë. Disnivelimet janë të identifikuar në hyrje të objektit dhe poashtu në mes të kthinave, përderisa shkallët për në katin e parë janë shumë të pjerrëta dhe e vetmja mënyrë për të shkuar lartë. Paraqiten poashtu pragjet dhe pengesat e tjera fizike.
- Në Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit të dy ndërtesat janë të paqasshme për personat me aftësi të kufizuara, duke qenë se shkallët mbeten e vetmja mënyrë e komunikimit vertikal. Pengesat fizike janë të vërejtshme edhe në përdhese përmes disnivelimeve në hyrje. Mungon gardhi adekuat të shkallët dhe paraqet rrezikshmëri në lëvizje.
- Në Muzeun e Kalasë edhe pse ekzistojnë rampat dhe ato mundësojnë qasshmërinë për PAK në kthinat e muzeut, dhe brenda objektit nuk ka ndërrim nivelesh, infrastruktura aktuale deri në Kompleksin e Kalasë së Prizrenit është jo adekuate dhe e pamundëson qasshmërinë për personat me aftësi të kufizuara.
- Në Muzeun e Elektroekonomisë ekzistojnë pengesa fizike që në oborrit e objektit, në të cilin dyshemeja (me gurë) është e papërshtatshme për lëvizje të PAK. Poashtu shkallët janë e vetmja formë e komunikimit për katin e parë. Ato janë të papërshtatshme dhe pa gardh rrethues, duke paraqitur rrezik edhe për fëmijët.



**IDENTIFIKIMI I PENGESAVE NË QASSHMERI**



Fig. 15. Ilustrime të identifikimit të barrierave fizike: a.) Muzeun Arkeologjik, b.) Muzeun Etnologjik. Për më shumë, në shtojcën e hulumtimit





#### **4.5. SHFYTËZUESHMËRIA DHE KËNAQSHMËRIA NGA ANA E QYTETARËVE**

---

Me qëllim të matjes së shkallës së shfrytëzueshmërisë dhe kënaqshmërisë së qytetarëve për institucionet muzeale ekszistuese të qytetit të Prizrenit, në kuadër të këtij hulumtimi është realizuar një anketë me qytetarë. Në kuadër të pyetësorit të hapur, japë pyetur 115 repodentë, të cilët kanë dhënë pikëvështrimet e tyre lidhur me nivelin e shërbimeve që muzetë ofrojnë, njohuritë e tyre lidhur me numrin e tyre e deri në propozime konkrete rreth përmirësimit të shërbimeve aktuale. Rezultatet e këtij pyetësori janë në vazhdim.

1% 100%

### 1.GJINIA

GRUA	48.3%
BURRË	51.7%

### 2.MOSHA

18-24	32.2%
25-34	29.6%
35-44	12.2%
45-54	12.2%
55-65	8.7%
65+	5.2%

### 3.QYTETI

PRIZREN	98.2%
DRAGASH	0.9%
SUHAREKË	0.9%

### 4. A KENI VIZITUAR NDONJËRIN NGA MUZETË E QYTETIT TË PRIZRENIT?

PO	78.4%
JO	21.6%

### NËSE PO:

### 5. SA HERË KENI VIZITUAR MUZETË E QYTETIT TË PRIZRENIT?

1 HERË	20.9%
2-5 HERË	44.0%
MË SHUMË SE 5 HERË	35.1%

## NËSE PO:

### 6. CILA NGA ARSYET E MËPOSHTME LIDHET ME MOS VIZITËN TUAJ NË NJËRIN NGA MUZETË E PRIZRENIT?



### 7. MUZETË E QYTETIT TE PRIZRENIT I KENI VIZITUAR:




### 8. A E DINI SA MUZE AKTIVE POSEDON QYTETI I PRIZRENIT?





## 9. NËSE PO, A MUND T'I LISTONI (APO NUMËRONI) ATO:



## 10. ARSYEJA E VIZITËS TUJ NË MUZETË E PRIZRENIT ËSHTË PËR SHKAK TË INTERESIMIT TUJ PËR:



## 11. SI MUND TA VLERËSONI EKSPERIENCËN NË MUZETË E QYTETIT TË PRIZRENIT (DUKE U REFERUAR NË ATO MUZE QË JU KENI VIZITUAR?)



## 12. LISTONI ELEMENTET TË CILAT MENDONI SE MUND TË PËRMIRËSOJNË GJENDJEN EMUZEVE TË CILAT I KENI VIZITUAR (SHEMBULL: MË SHUMË INFORMATA TË SHKRUARA LIDHUR ME EKSPONATET DHE PERIU DHËN TË CILËN PREZENTOJNË; MË SHUMË INFORMATAVE NGA PUNONJËSIT GJATË VIZITËS SË MUZEUT; RI-ORGANIZIMI I HAPËSIRAVE EKSPOZUESE; SIGURIMI I QASSHMËRISË PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA, ETJ.)

SHUMICA E PERSONAVE KANË LISTUAR ELEMENTET E LARTPËRMENDURA POR NË PERGJITHËSI KANË SHTUAR EDHE PIKA TË TJERA SI KËTO:

### -INFORMIMI:

CICERONËT TË JENË NË NUMËR TË MJAFTUESHËM, MË AKTIV DHE MË INFORMUES;  
 OFRIMI I PËRKTHIMEVE NË GJUHË TË NDRYSHME BOTËRORE;  
 APLIKIMI I IDEVE INOVATIVE DIXHITALE PËR PREZENTIM HISTORIK;  
 PROMOVIMI I MUZEVE PËR TË TËRHEQUR VIZITORËT;  
 ORIENTIMI NË QYTET PËR TEK MUZET;

### -ORARI:

MUZETË TË KENË ORAR TË CAKTUAR TË PUNËS;  
 MUZETË TË JENË TË HAPUR GJITHMONË;

### -QASSHMËRIA DHE GJITHËPËRFSHIRJA:

QASJA PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA;  
 OFRIMI I SHPJEGIMEVE PËR PERSONAT E SHURDHËR;  
 TË KETË TOALETE PËR PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA;  
 SIGURIA NË LËVIZJE;

### -EKSPONATET:

EKSPOZIMI KREATIV I EKSPONATEVE;  
 MBROJTJA E EKSPONATEVE NGA FAKTORËT E JASHTËM;  
 PASURIMI I VAZH DUESHËM I MUZEVE NË MËNYRË QË TË RRI TET NUMRI I VIZITORËVE;  
 MË SHUMË INFORMATA TË SHKRUARA LIDHUR ME EKSPONATET DHE PERIU DHËN TË CILËN PREZENTOJNË;  
 RI-ORGANIZIMI I HAPËSIRAVE EKSPOZUESE;  
 MË SHUMË EKSPOZITA;

### -GJENDJA FIZIKE E MUZEVE:

RESTAURIMI I DISA MUZEVE, URGJENT I HAMAMIT;  
 ZGJERIMI I NDËRTESAVE;  
 ME SHUMË HAPËSIRA EKSPOZUESE;  
 RREGULLIMI I JASHTËM;  
 RI-FUNKSIONALIZIMI;  
 RENOVIMI;

### -RRITJA E INVESTIMEVE:

MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT TË MERRET MË SHUMË ME MANGËSITË E KULTURËS SË VENDIT TONË;

### -MIRËEMBAJTJA DHE PASTËRTIA TË JENË NË NIVEL;

### -AMBIENTET E BRENDSHME TË NGROHEN MJAFTUESHËM;

### -KAMERAT E SIGURISË TË JENË AKTIVE;

### -TË PËRMIRËSOHET NDRIÇIMI I JASHTËM DHE I BRENDSHËM;

### -PRANIA E PARKINGJEVE;

### -PRANIA E TOALETEVE;

### -TË SHTOHEN HAPËSIRA KREATIVE PËR SHITJE TË SUVENIREVE ME SIMBOLE HISTORIKE NË KUADËR TË MUZEVE.

## 4.6. PROBLEMET DHE PROPOZIMET

Fig. 16. Momente nga realizimi i fokus grupeve në ambientet e Muzeut Arkologjik, Prizren



Me qëllim të identifikimit të problemeve dhe potencialeve të institucioneve muzeale të qytetit të Prizrenit, në kuadër të kësaj analize janë organizuar dy fokus grupe, njëri me profesionistë dhe tjetri me qytetarë dhe grupe të caktuara të komunitetit.

Fokus grupi i parë ka patur në fokus punonjësit e muzeve aktuale të qytetit të Prizrenit, historian, arkitektë, arkeologë, etnologë, albanologë dhe guida turistike. Ndërsa fokus grupi i dytë ka patur për fokus qytetarë, përfaqësues të shkollave fillore, përfaqësues të organizatave studentore si dhe të organizatave të personave me aftësi të kufizuara. Problemet dhe potencialet e identifikuara janë prezentuar në vijim.



## PËRMBLEDHJE DISKUTIMESH NGA FOKUS GRUPI I PARË ME PROFESIONISTË

PROBLEMET	PROPOZIMET
<ul style="list-style-type: none"> <li>— Mungesë e resurseve humane në të gjitha muzetë e Prizrenit. Kjo e vështirëson operimin e muzeve, duke i lënë disa prej tyre jofunksional, apo të hapur vetëm në orare të caktuara. Poashtu në rastet kur stafi ekziston, por është në numër të kufizuar, kjo ndikon në mbingarkesë të stafit ekzistues, dhe në profesionalizëm të venitur (duke qenë se mungojnë të gjitha profilet e nevojshme nga diciplinat specifike)</li> <li>— Nevojë për rikonceptimin e muzeve dhe ekspozitës ekzistuese (sidomos për Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit)</li> <li>— Mungesë e theksuar e shenjzimeve të cilat paralajmërojnë vizitorët për lokacionet e muzeve të qytetit të Prizrenit</li> <li>— Mungesë e informatave në kuadër të muzeve lidhur me llojin e ekspozitës/ekspozateve, periudhave të cilave ju takojnë dhe informata të tjera të rëndësishme të cilat do të ndihmonin vizitorët në mënyrë që të përfitonin sa më shumë informacion</li> <li>— Mungesë e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mungesë elementeve asistuese për kategoritë e tjera, duke përfshirë të verbërit, personat e shurdhër etj.</li> <li>— Mungesë e promovimit të muzeve në ndërlidhje me vizitorët potencial dhe zyren e turizmit</li> <li>— Mungesë e brendimit të muzeve</li> <li>— Mungesë e hapësirave të cilat do të shërbenin për depone të ekspozateve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>— MKRS të angazhohet drejt analizës së resurseve humane të nevojshme, profileve profesionale specifike dhe shtuarjes së kapaciteteve operuese në mënyrë që të rritet efikasiteti në punë dhe të gjitha muzetë të jenë të qasshme për vizitorët në baza të rregullta</li> <li>— Të punohet drejt digjitalizimit të data-bazave të ekspozateve ekzistuese</li> <li>— Të bëhet ridizajnimi i hapësirave ekspozuese dhe të rikonceptohen ekspozitat ekzistuese, bazuar në normativat dhe trendet aktuale</li> <li>— Të vendosen shenjzimet paralajmëruese në rrethinë të muzeve aktuale</li> <li>— Të pregaditet dhe instalohet shenjzimi informues në të gjitha muzetë, duke dhënë informata të sakta lidhur me llojin e koleksionit, periudhat të cilat koleksioni reprezenton etj,</li> <li>— Të përmirësohen kushtet fizike sa l përket ndriqimit adekuat, ajrosjes dhe kontrollimit të lagështisë</li> <li>— Në hapësirat të cilat është e mundshme, të intervenohet me qëllim të eliminimit të barrierave fizike</li> <li>— Të punohet drejt ofrimit të asistencës së nevojshme për personat e shurdhër dhe me pengesa në dëgjim</li> <li>— Të punohet drejt sigurimit të shenjzimit informues në alfabetin e Bail-it dhe të vendosjes së pllakave taktile</li> <li>— Të punohet drejt dizajnit të ekspozitave virtuale</li> <li>— Të punohet në drejtim të brendimit të muzeve në veçanti, dhe rrjetit të muzeve të qytetit të Prizrenit në përgjithësi</li> </ul>

**PËRMBLEDHJE DISKUTIMESH NGA FOKUS GRUPI I PARË ME QYTETARË**

PROBLEMET	PROPOZIMET
<ul style="list-style-type: none"> <li>— Qytetarët nuk kanë njohuri që muze të caktuar ekzistojnë (rasti i Muzeut Arkeologjik)</li> <li>— Mungesë e theksuar e shenjzimeve të cilat paralajmërojnë vizitorët për lokacionet e muzeve të qytetit të Prizrenit</li> <li>— Mungesë e informatave në kuadër të muzeve lidhur me llojin e ekzpozitës/eksponateve, periudhave të cilave ju takojnë dhe informata të tjera të rëndësishme të cilat do të ndihmonin vizitorët në mënyrë që të përfitonin sa më shumë informacion</li> <li>— Mungesë e qasshmërisë për personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mungesë e elementeve asistuese për kategoritë e tjera, duke përfshirë të verbërit, personat e shurdhër etj.</li> <li>— Mungesë e kalendarëve të ngjarjeve kulturore të cilat do të mund të integronin dhe promovimin komponentën e edukimit / vizitat e organizuara të nxënësve dhe studentëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>— Të punohet më shumë, dhe sa më parë drejt promovimit të muzeve eksistuese të qytetit të Prizrenit</li> <li>— Të vendosen shenjzimet paralajmëruese në rrethinë të muzeve aktuale</li> <li>— Të pregaditet dhe instalohet shenjzimi informues në të gjitha muzetë, duke dhënë informata të sakta lidhur me llojin e koleksionit, periudhat të cilat koleksioni reprezenton etj,</li> <li>— Të punohet drejt arritjes së muzeve gjithëpërfshirëse, të qasshme për Personat me Aftësi të Kufizuara.</li> <li>— Deri në qashtëri të plotë, personave me aftësi të kufizuar të ju mundësohet qasje në ekspozitat virtuale</li> <li>— Të inciohet bashkëpunimi MKRS – DA me qëllim të kooperimit për zbatimin e aktiviteteve jashtë kurrikulare të nxënësve dhe studentëve, në kuadër të hapësirave muzeale</li> </ul>





## **PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME**

Muzetë, luajnë një rol të rëndësishëm për shoqërinë, konsideruar faktin që përfaqësojnë institucione të cilat hulumtojnë, mbledhin, koservojnë, ekspozojnë dhe intepretojnë trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme të një shteti. Si të tilla, institucionet muzrale, sipas koncepteve dhe standardizimeve ndërkombëtare, duhet të jenë të hapura për publikun, të aksesueshme për të gjithë dhe në mënyrë konstante të nxisin frekuentimin e vizitorëve, duke ofruar përvoja të ndryshme për edukim, rekreim, reflektim dhe shkëmbim njohurish.

Qyteti i Prizrenit, duke bartur joformalisht edhe epitetin e kryeqytetit kulturor të Republikës së Kosovës, posedon një gamë të gjerë të muzeve, të cilat njihërit dëshmojnë për një pasuri kulturore të Rajonit Jug sa i përket koleksionimit të artefakteve kulturore, historike dhe shkencore. Megjithatë, kjo analizë gjashtëmujore e ndërmarrë në pesë muzetë kryesore të qytetit të Prizrenit, nxjerr në pah se institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit përkundër potencialit të madh që bartin si objekte arkitektonike fizike në njërin anë, dhe gamës së gjerë dhe të qmueshme të ekspozateve të cilat i ekspozojnë në anën tjetër, nuk operojnë në mënyrë më të mirë të mundshme.

Përgjatë aktivitetit hulumtues të ndërmarrë në institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit, është gjetur se:

**1. Institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit nuk janë të dokumentuara në aspektin operues arkitektonik. Mungon një dokumentim i objekteve arkitektonike të muzeve të Prizrenit, bashkarisht me dokumentimin e ekspozitave aktuale. Lidhur me këtë, ky hulumtim përmbledh për herë të parë në një dokument të vetëm dokumentimin arkitektonik të pesë muzeve kryesore të qytetit të Prizrenit, në të cilat është prezentuar struktura fizike e objekteve, e plotësuar me mobiliarin aktual në të cilin janë të vendosura ekspozatat aktuale. Ky dokumentim do të mund të shërbëjë cilëndo iniciativë të MKRS-së apo KKP-së në ristrukturim dhe ridizajnim të strukturave ekzistuese të institucioneve muzeale të Prizrenit.**

**2. Nuk ekziston një databazë e të dhënave statistikore lidhur me numrin e vizitorëve të muzeve dhe të hyrave që ata gjenerojnë. Ky fakt rëndon aktivitetin hulumtues dhe cilëndo analizë të mundshme lidhur me gjendjen aktuale të muzeve të Prizrenit me qëllim të identifikimit të problematikave dhe potencialeve që këto objekte bartin. Lidhur më këtë, ky hulumtim ka prezentuar të dhëna të siguruara përmes shkresave zyrtare në institucionet muzeale aktuale, duke gjetur se qytetarët, studiuesit dhe hulumtuesit e kanë të pamundur që informata të tilla të mund të sigurojnë në mënyrë vetanake. Kjo e dhënë dëshmon se institucionet muzeale të Prizrenit operojnë në mënyrë të mbyllur dhe jo transparente.**

**3. Nuk ekzistojnë informata të qasshme online lidhur me llojin e muzeve, venddodhjen, orarin e punës dhe të dhëna të tjera të cilat do të shërbenin në drejtim të promovimit të institucioneve muzeale të qytetit të Prizrenit. Muzetë aktual nuk posedojnë faqe zyrtare në internet dhe poashtu nuk janë të prezentuar në platformat ekzistuese të institucioneve prej të cilave administrohen. Kjo e dhënë e identifikuar përgjatë mbledhjes së materialit hulumtues, dëshmon për faktin se muzetë aktuale të qytetit të Prizrenit përkundër potencialit të madh që bartin, janë të pa promovuara dhe të pa qasshme virtuelisht në një momentum kur informata online ka një rol të jashtëzakonshëm drejt informimit dhe tërheqjes së qytetarëve në përgjithësi, dhe turistëve në veçanti. Gjithashtu, përmes analizave në terren, procesit të intervistimit, realizimit të fokus grupeve me profesionistë dhe grupe të nënpërfaqësuesara të komunitetit si dhe anketimit me qytetarë, ky hulumtim vie në përfundim edhe të këtyre problematikave:**

**4. Nuk ekziston një model unik, me qëllime të definuara qartë dhe me vizion të unifikuar për administrimin aktual dhe të ardhmen e muzeve të qytetit të Prizrenit, duke qenë se administrimi i tyre bëhet në një modalitet të përzier, nga niveli qendror dhe lokal. Shumica e muzeve aktuale administrohen direkt nga MKRS, apo përmes institucioneve vartëse, ndërsa poashtu ekziston prezencë e**

administrimit nga niveli lokal (KP) dhe të organizatave jo-qeveritare në raste të caktuara (rasti i Muzeut Etnologjik – Shtëpia e Shehzades). Ky hulumtim nxjerr në pah se mungesa e një modeli unik të menaxhimit, i cili do të unifikonte objektivat menaxheriale dhe operuese, u ka kushtuar muzeve aktuale të qytetit të Prizrenit në drejtim të mungesës së një brendimi të unifikuar, politikave të përbashkëta për tërheqjen e vizitorëve dhe përfshirjes në kalendarë kulturor dhe pako të përbashkëta turistike.

**5. Muzetë e qytetit të Prizrenit janë të pa qasshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara.** Të gjitha muzetë e Prizrenit bazuar në të gjeturat dhe ekzaminimet në terren, rezultojnë të jenë të pa qasshëm për Personat me Aftësi të Kufizuara, përveç Muzeut të Kalasë së Prizrenit, i cili edhe pse është i qasshëm si objekt, është i rrethuar me infrastrukturë të pa qasshme për PAK. Mos qasshmëria në institucionet muzeale të qytetit të Prizrenit konsiston jo vetëm në faktin se në këto objekte janë identifikuar barrierat fizike, por edhe për faktin se në këto objekte nuk ofrohet infrastrukturë fizike dhe operacionale edhe për personat e shurdhër, të verbër, persona me zhvillim të vonuar etj. Gjithashtu mungojnë aktivitetet që do të stimulonin pjesëmarrjen e vizitorëve nga ky grup i komunitetit.



**6. Shumica e muzeve të qytetit të Prizrenit qëndrojnë të mbyllur, në kundërshtim me misionin e institucioneve muzeale. Vetëm dy nga shtatë muzetë ekzistuese të Prizrenit (respektivisht Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Muzeun Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla) operojnë në orar të rregullt, të hapur pesë deri në gjashtë ditë në javë, në tetë orë pune. Të gjitha muzetë e tjera mbeten të mbyllura për vizitorë, përveç në raste të dakordimit paraprak (Muzeu i Elektroekonomisë – Hidroeletrana “Prizrenasja) apo gjatë sezonës së verës (Muzeu i Kalasë). Këtë problematikë e determinon mungesa e stafit. Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi, mungesa e resurseve humane është ndër indikatorët kryesorë në mbajtjen mbyllur të shumicës së muzeve, duke ndikuar në këtë mënyrë në zbehjen e ofertës turistike të qytetit të Prizrenit, pamundësinë e pasurimit kulturor të qytetarëve, dhe humbjeve ekonomike nga të ardhurat që do të mund të gjeneroheshin nga vizitorët potencial.**

**7. Nuk ekzistojnë shenjzues në kontekst të gjerë dhe të ngushtë urban lidhur me venddodhjen e muzeve të qytetit të Prizrenit. Qytetarët në përgjithësi, dhe turistët në veçanti e kanë të vështirë identifikimin e objekteve muzeale të qytetit të Prizrenit. Mungesa e shenjzuesve është duke ndikuar drejtpërsëdrejti në humbjen e potencialit që muzetë bartin, duke ndikuar dhe në numrin dhe interesimin e vizitorëve potencial.**

**8. Shumica dërmuese e muzeve të qytetit të Prizrenit nuk posedojnë tabela informuese lidhur me llojin e eksponateve dhe artefakteve të ekspozuara, emërtimeve burimore të tyre dhe periudhave historike të cilave u takojnë. Mungesa e informatave të shkruara dhe udhëzuesve lidhur me kategorinë e muzeve në përgjithësi, dhe llojin e eksponateve në veçanti (përveç rastit të Muzeut të Kalasë) është duke ndikuar drejtpërsëdrejti në mos-informimin adekuat të vizitorëve. Poashtu, mungesa e orientimit mbi ekspozitat aktuale është duke ndikuar në sekuencat e lëvizjes së vizitorëve, të cilët, bazuar në analizën e lëvizshmërisë së vizitorëve të ndërmarrë në kuadër të këtij hulumtimi, shpesh largohen nga muzetë pa i vizituar të gjitha hapësirat.**

**9. Muzetë e qytetit të Prizrenit nuk kanë të zhvilluara programe hulumtuese dhe ato të interaksionit kulturor. Si rezultat i kësaj, ato zhvillojnë momentalisht vetëm komponentën e ekspozimit të eksponateve/artefakteve. Mungon zhvillimi i komponentes së hulumtimit, e cila specifikohet në konceptet ndërkombëtare të institucioneve muzeale si një prej komponenteve më të rëndësishme të prodhimit të dijes dhe informacionit. Poashtu, asnjëri nga muzetë aktuale nuk operon në bazë të një kalendarit kulturor i cili do të mund të ofronte programe të veçanta për fëmijë, ngjarje kulturore në formë të debateve, ekspozitave të përkohshme, kuizeve të trashëgimisë, vizitave të organizuara të nxënësve dhe grupeve të nënpërfaqësuar të komunitetit etj.**



**10. Muzetë e qytetit të Prizrenit përgjithësisht nuk tregojnë përshtatshmëri me konceptet e reja të institucioneve muzeale.** Shumica e muzeve aktuale të qytetit të Prizrenit rezultojnë të jenë vetëm hapësira “të vdekura” ku vetëm ndodh ekspozimi i ekspozateve dhe thesareve të së kaluarës, përderisa konceptet e reja të institucioneve muzeale synojnë që hapësirat e muzeve të kthehen në mjedise për zhvillim të projekteve, biblioteka, galeri e salla ekspozimi dhe të jenë institucione të pajisura me teknika bashkëkohore të prezentimit dhe ekspozimit.

Bazuar në problemet dhe mangësitë e identifikuara, kjo analizë rekomandon:

- Definimin e aspektit legjislativ i cili rregullon themelimin dhe funksionimin e muzeve
- Unifikimin e vizionit dhe objektivave administruese të muzeve të qytetit të Prizrenit, përmes bashkëpunimit në nivel qendror dhe lokal
- Krijimin e një platforme interaktive lidhur me muzetë aktuale të qytetit të Prizrenit, historikun, venddodhjen, llojin e ekspozateve dhe ngjarjeve kulturore që ato ofrojnë me qëllim të ofrimit të informacionit online për qytetarët në përgjithësi, dhe turistët në veçanti
- Krijimin e një database lidhur me numrin e vizitorëve dhe të hyrat e gjeneruara nga vizitat në muze
- Gjetjen e modaliteteve për sigurimin e stafit shtesë në mënyrë që të sigurohet hapja e muzeve që aktualisht rezultojnë të mbyllur për vizitorët
- Ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve intelektuale/profesionale
- Intervenimin fizik në objektet aktuale të muzeve të qytetit të Prizrenit me qëllim të eliminimit të barrierave fizike.
- Ofrimin e infrastrukturës fizike dhe operacionale për personat e verbër, personat e shurdhër, personat me pengesë në zhvillim dhe kategoritë e tjera, drejt arritjes së konceptit të muzeve gjithëpërfshirëse, sipas normave dhe standardeve ndërkombëtare
- Vendosjen e shenjzimit në kontekst urban me qëllim të informimit të vizitorëve lidhur me lokacionin e muzeve, orarin e punës dhe çmimet
- Dizajnimin dhe vendosjen e tabelave fizike me të të dhënave të shkruara (në gjuhët lokale, në gjuhën angleze dhe në alfabetin e Brail-it) lidhur me kategorinë dhe historikun e muzeut; llojin, emërtimet dhe periodhat e ekspozateve me qëllim të përcaktimit të sekuencës së lëvizjes së vizitorëve
- Ridizajnimin e ekspozitave ekzistuese (Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit) dhe dizajnimi i ekspozitave në mungesë (Muzeu i Elektroekonomisë – Hidroelektrana “Prizrenasja)
- Adaptimin e koncepteve bashkëkohore në trajtimin e muzeve, përmes integritit të programeve hulumtuese dhe interaksionit kulturor e aktiviteteve joformale, duke përfshirë organizimin e ngjarjeve kulturore për të gjitha grupmoshat, organizimin e konferencave, simpoziumeve, ekspozitave, promovimeve etj.

## BIBLIOGRAFIA

- [1] Alexander, E.P., Alexander, M., "Museums in motion: an introduction to the history and functions of museums", Rowman & Littlefield, 2007
- [2] Britannica, "Museums Structure and Operation", qasur në Nëntor, 2022  
<https://www.britannica.com/topic/museum-cultural-institution/Museum-structure-and-operations>
- [3] EC Ma Ndryshe, "Udhëzim administrativ për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuar". Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Gusht 2016
- [4] Ed. Littlefield, D., "Metric Handbook – Planning and Design Data, Third Edition, Elsevier Ltd., 2008, fq.450 - 455
- [5] EC Ma Ndryshe, "Prizreni 'qytet muze' pa muze?", Maj 2008, qasur në Nëntor 2022  
<https://www.ecmandryshe.org/?page=1,17,530>
- [6] EC Ma Ndryshe, "Udhëzim Administrativ - për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara", 2016, qasur në Nëntor, 2022,  
[https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153\\_udhezimi\\_administrativ.pdf](https://www.ecmandryshe.org/repository/docs/161021105153_udhezimi_administrativ.pdf)
- [7] Findlen, P., "The Museum: its classical etymology and renaissance genealogy". Journal of the History and Collection.(1), 1989, fq. 59-78
- [8] Gëzim H., "Të dhëna të reja arkeologjike nga Kalaja e Prizrenit / Nouvelles données archéologiques sur la forteresse de Prizren". Iliria (në frëngjisht dhe shqip), qasur në Dhjetor 2022,  
[https://www.persee.fr/doc/iliri\\_1727-2548\\_2007\\_num\\_33\\_1\\_1073](https://www.persee.fr/doc/iliri_1727-2548_2007_num_33_1_1073)
- [9] Günay, B., "Museum concept from past to present and importance of museums as centers of art education", International Conference on Neë Horizons in Education INTE2012, 2012
- [10] "Hydro-Power Plant – Electrical Museum (Prizren)". Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës (në anglisht). Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, qasur në Dhjetor 2022,  
[https://web.archive.org/web/20200819220753/https://dtk.rks-gov.net/tkk\\_objekti\\_en.aspx?id=4591](https://web.archive.org/web/20200819220753/https://dtk.rks-gov.net/tkk_objekti_en.aspx?id=4591)
- [11] Intervista me Vesel Hoxhaj, arkeolog dhe udhëheqës i Muzetu Arkeologjik në Prizren, realizuar në Tetor, 2022 dhe informatat në platformë online të Muzeut Arkeologjik të Prizrenit,  
<https://www.facebook.com/muzeuarkeologjikiprizrenit/>
- [12] Jerliu, F., "Strategjia Kombëtare për Trashëgiminë Kulturore 2017 – 2027", Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, 2016

- [13] Këshilli Nërkombëtar i Muzeve (ICM – International Council of Museums), aprovuar në Konferencën e 26-të Gjenerale mbajtur në Pragë, më 24 Gusht 2022, qasur në Nëntor 2022, <https://icom.museum/en/news/icom-approves-a-new-museum-definition/>
- [14] Kosova, P., Historical and Cultural Monuments of the Albanian League of Prizren (Monumentet Historike dhe Kulturore të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit). Prizren, 2004
- [15] Manifesta14, “Muzeu i Kosovës”, qasur në Nëntor 2022, <https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/>
- [16] Mehmet, K., "Fjalori Enciklopedik i Kosovës". Vëll. 1. Prishtinë: Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. fq. 744 – 745, 2018
- [17] MKRS – faqja zyrtare, “Miratohet Koncept-dokumenti për Art dhe Kulturë” qasur në Nëntor, 2022, <https://www.mkrs-ks.org/?page=1,6,3041#.Y6bo1i-B2X0>
- [18] “Monuments of Albania”, qasur në Dhjetor 2022, <https://www.facebook.com/1531035643804187/photos/a.1531541350420283/2672133033027770/>
- [19] Montsho, G., “Making Museums Accessible to Those With Disabilities”, Museum Next, 2022, qasur në Nëntor, 2022, <https://www.museumnext.com/article/making-museums-accessible-to-those-with-disabilities/>
- [20] “Muzeu i Kalasë i gatshëm për vizitorë”, Kallxo.com, qasur në Dhjetor 2022, <https://kallxo.com/shkurt/muzeu-ne-kalane-e-prizrenit-i-gatshem-per-vizitore/>
- [21] Navafrete, T., “Teaching in Cultural Environments”, Digitalization in Museums - Chapter 27, Ed. Bille, T., Mignosa, A., Towse, R., 2020
- [22] Tzortzi, K. “*Museum Space – Where Architecture Meets Museology*”, Routledge, 2016, fq. 11-43



## LISTA E FIGURAVE

Fig.1. Ilustrim i pesë institucioneve muzeale të përhira në hulumtim.....	3
<u>Burimi:</u> Autorët	
Fig.2. Palazzo Medici, muzeu i parë në Evropë.....	7
<u>Burimi:</u> <a href="http://www.florencewebguide.com/palazzo-medici-riccardi.html">http://www.florencewebguide.com/palazzo-medici-riccardi.html</a>	
Fig.3. a. Muzeu Glyptotech në Munich, b. Altes Museum në Berlin, c. Alte Pinakothek në Munich.....	8
<u>Burimi:</u> <a href="https://en.wikipedia.org/wiki/Glyptothek">https://en.wikipedia.org/wiki/Glyptothek</a> <a href="https://de.wikipedia.org/wiki/Altes_Museum#/media/Datei:Altes_Museum,_Berlin_2012.jpg">https://de.wikipedia.org/wiki/Altes_Museum#/media/Datei:Altes_Museum,_Berlin_2012.jpg</a> <a href="https://www.lonelyplanet.com/germany/munich/maxvorstadt/attractions/alte-pinakothek/a/poi-sig/409068/1342296">https://www.lonelyplanet.com/germany/munich/maxvorstadt/attractions/alte-pinakothek/a/poi-sig/409068/1342296</a>	
Fig.4. Muzeu Guggenheim, New York.....	8
<u>Burimi:</u> <a href="https://www.history.com/this-day-in-history/guggenheim-museum-opens-in-new-york-city">https://www.history.com/this-day-in-history/guggenheim-museum-opens-in-new-york-city</a> <a href="https://www.cntraveler.com/activities/new-york/solomon-r-guggenheim-museum">https://www.cntraveler.com/activities/new-york/solomon-r-guggenheim-museum</a>	
Fig.5. a.) Muzeu i Historisë së Natyrës, Los Angeles, b.) Muzeu Arkelgjik, Izrael, c.) Muzeu i Artit, Vienë.....	9
<u>Burimi:</u> <a href="https://metrolinktrains.com/explore/los-angeles-county/natural-history-museums-of-los-angeles-county/">https://metrolinktrains.com/explore/los-angeles-county/natural-history-museums-of-los-angeles-county/</a> <a href="https://www.imj.org.il/en/wings/archaeology">https://www.imj.org.il/en/wings/archaeology</a> <a href="https://www.sothebys.com/en/museums/kunsthistorisches-museum-wien">https://www.sothebys.com/en/museums/kunsthistorisches-museum-wien</a>	
Fig.6. Tipologjia hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale në relacion me lëvizjen e vizitorëve.....	11
<u>Burimi:</u> Metric Handbook	
Fig.7. Modalitetet bazike të ekspozimit.....	12
<u>Burimi:</u> Metric Handbook	
Fig.8. Raste të qasshmërisë në muzetë botërore: a. përdorimi i alfabetit të Brail-it, b. qasshmëria fizike pa barriera.....	14
<u>Burimi:</u> <a href="https://www.wonderbaby.org/articles/tactile-museums">https://www.wonderbaby.org/articles/tactile-museums</a> <a href="https://thedali.org/visit/accessibility/">https://thedali.org/visit/accessibility/</a>	
Fig.9. Muzeu Kombëtar i Kosovës, Prishtinë.....	18
<u>Burimi:</u> <a href="https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/">https://manifesta14.org/sq/venue/muzeu-i-kosoves/</a>	

Fig. 10. a.) Muzeu i qytetit të Mitrovicës, b.) Muzeu i qytetit të Ferizajit, c.) Muzeu Etnologjik në Pejë, d.) Muzeu Rajonal i Gjilanit, e.) Muzeu Etnografik i Gjakovës, f.) Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.....	19
<u>Burimi:</u> <a href="https://shqip.com/muzeu-i-qytetit-te-mitrovices-shfaqet-ne-forme-virtuale-per-qytetaret/">https://shqip.com/muzeu-i-qytetit-te-mitrovices-shfaqet-ne-forme-virtuale-per-qytetaret/</a>	
<a href="https://www.facebook.com/photo/?fbid=296550345835771&amp;set=a.296550332502439">https://www.facebook.com/photo/?fbid=296550345835771&amp;set=a.296550332502439</a>	
<a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Peja#/media/Skeda:Muzeu_etnologjik_(Konaku_i_Tahir_Beut),_Peje_4.jpg">https://sq.wikipedia.org/wiki/Peja#/media/Skeda:Muzeu_etnologjik_(Konaku_i_Tahir_Beut),_Peje_4.jpg</a>	
<a href="https://sq.wikipedia.org/wiki/Skeda:Muzeu_i_Gjilanit.jpg">https://sq.wikipedia.org/wiki/Skeda:Muzeu_i_Gjilanit.jpg</a>	
<a href="https://vizitoshqip.com/turizmi/details/muzeu-etnografik-i-gjakoves">https://vizitoshqip.com/turizmi/details/muzeu-etnografik-i-gjakoves</a>	
<a href="https://vizitoshqip.com/turizmi/details/kompleksi-i-lidhjes-shqiptare-te-prizrenit">https://vizitoshqip.com/turizmi/details/kompleksi-i-lidhjes-shqiptare-te-prizrenit</a>	
Fig. 11. Muzetë aktual të qytetit të Prizrenit (a) Muzeu Arkeologjik – Hamami i Shemsidin Beut dhe Sahatkulla, (b) Muzeu Etnologjik – Shtëpia e Shehzades, (c) Muzeu i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, (d) Muzeu i Kalasë së Prizrenit dhe (e) Muzeu i Elektranës – Hidroelektrana “Prizrenasja”, (f) Muzeu i Hapur Arkeologjik dhe (g) Muzeu i Nënës Terezë.....	23
<u>Burimi:</u> <a href="https://prizrenisot.net/kulla-e-sahatit-muzeu-arkeologjik/">https://prizrenisot.net/kulla-e-sahatit-muzeu-arkeologjik/</a> , autorët, <a href="https://en.tripadvisor.com">https://en.tripadvisor.com</a> , autorët, autorët, <a href="https://ëëë.ecmandryshe.org">https://ëëë.ecmandryshe.org</a> , <a href="https://www.koha.net/kulture/224346/rikthehet-vemendja-te-muzeu-i-nenes-tereze-ne-prizren-qe-u-nis-m-e-2010/">https://www.koha.net/kulture/224346/rikthehet-vemendja-te-muzeu-i-nenes-tereze-ne-prizren-qe-u-nis-m-e-2010/</a>	
Fig. 12. Hartëzim i institucioneve muzeale të përfshira në hulumtim.....	24
<u>Burimi:</u> Autorët	
Fig. 13. Tipologjitë e hapësirave të ekspozimit në objektet muzeale të Prizrenit në relacion me lëvizjen e publikut.....	39
<u>Burimi:</u> Autorët	
Fig. 14. Sekuencat e lëvizjes në: a.) Muzeun Arkeologjik, b.) Muzeun e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Për më shumë, në shtojcën e hulumtimit.....	40
<u>Burimi:</u> Autorët	
Fig. 15. Ilustrime të identifikimit të barrierave fizike: a.) Muzeun Arkeologjik, b.) Muzeun Etnologjik. Për më shumë, në shtojcën e hulumtimit.....	43
<u>Burimi:</u> Autorët	
Fig. 16. Momente nga realizimi i fokus grupeve në ambientet e Muzeut Arkologjik, Prizren.....	50
<u>Burimi:</u> Autorët	

## PËR EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijës empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente:


1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijën. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre ngagjeneratat e ardhshme. Njësoj si demokracia, ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijës së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.







## PJESA GRAGIKE

### PËRMBAJTJA

KY HULUMTIM U REALIZUA NGA EC MA NDRYSHE NË KUADËR TË PROJEKTIT "PROMOVIMI I TRASHË-GIMISË KULTURORE PËRMES FUQIZIMIT TË SHËRBIMEVE GJITHËPËRFSHIRËSE DHE INOVATIVE NË INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË PRIZRENIT" MBËSHËTETUR NGA DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT NË PRIZREN.

MUZEU ARKEOLOGJIK - HAMAMI I  
SHEMSIDIN BEUT DHE SAHATKULLA **01**



MUZEU ETNOLOGJIK - SHTËPIA E  
SHEHZADES **02**



MUZEU I KOMPLEKSIT TË LIDHJES  
SHQIPTARE TË PRIZRENIT **03**



MUZEU I KALASË SË PRIZRENIT **04**



MUZEU I ELEKTROEKONOMISË -  
HIDROELEKTRANA "PRIZRENASJA" **05**



SITUACIONI, VENDOSJA NË  
KONTEKST URBAN



PLANIMETRI/TË  
PRERJE/ FASADA


DOKUMENTIMI I GJENDJES  
EKZISTUESE/ FOTOGRAFITË

IDENTIFIKIMI I PENGESAVE  
NË QASSHMËRI

ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE

ANALIZA E LËVIZJES SË VIZITORËVE  
(PËR MUZETË E HAPUR PËR VIZITORË)







1968/1978

MUZEU I KOMPLEKSIT TË  
LIDHJES SHQIPTARE TË  
PRIZRENIT

1975

MUZEU ARKEOLOGJIK -  
HAMAMI I SHEMSIDIN BEUT  
DHE SAHATKULLA

1979

HIDROELEKTRANA -  
MUZEU I ELEKTROEKONOMISË

2013


MUZEU ETNOLOGJIK -  
SHTËPIA E SHEHZADES

2016


MUZEU I KALASË  
SË PRIZRENIT



MUZEU ARKEOLOGJIK








### **MUZEU ARKEOLOGJIK - HAMAMI I SHEMSIDIN BEUT DHE SAHATKULLA**

Hamami i Shemsedin Ahmet Beut dhe Sahat Kulla gjenden në pjesën perëndimore të qytetit të vjetër. Hamami është ndërtuar në shekullin XV, përkatësisht në vitin 1498. Nuk dihet se deri në cilin vit është përdorur si hamam, por dihet se hamami nuk ka kryer funksionin e tij që nga mesi i shek. XIX kur mbi hapësirën e ngrohtë të Hamamit është ndërtuar Sahat Kulla.


Në fund të viteve 60' dhe në fillim të viteve 70' të shekullit XX në Rajonin e Prizrenit, kryesisht në rrjedhën e Drinit të Bardhë u zbuluan shumë lokalitete arkeologjike, u zhvilluan shumë ekspedita gjurmuese nga të cilat u zbulua një material shumë i pasur arkeologjik e të cilat u vendosën në objektin e trashëgimisë kulturore të Hamamit të Shemsedin Beut dhe të Sahat Kullës. Muzeu trajton materialin arkeologjik nga lokalitete arkeologjike të Rajonit të Prizrenit, gjegjësisht nga komuna e Prizrenit, Dragashit, Rahovecit, Malishevës dhe Suharekës. Materiali ei ekspozuar prezanton një periudhë të gjerë kohore të artefakteve, që nga Neoliti, Eneoliti, Periudha e Bronzit, Periudha e hekurit, Periudha Antike e Romake, Mesjeta dhe Periudha Osmane.

Hamami i Shemsedin Ahmet Beut është ndër hamamet më të vjetra të Ballkanit dhe së bashku me Sahat Kullën përbëjnë ndër objektet më interesante dhe karakteristike të qytetit të Prizrenit.












Muzeu Arkeologjik përbën një kompozicion të veçantë arkitektonik. Gërshetimi i Hamamit së bashku me Sahat Kullën, dhe vendosja këtu e muzeut arkeologjik, është rast unik që nuk gjendet diku tjetër. I restauruar së fundmi, me rikonceptim të ekspozitës, ky muze përbën ndër muzetë më të kompletuar të Prizrenit sa i përket gjendjes ekzistuese të objektit ku operon, cilësisë së ekspoziturës dhe shërbimeve të ofruara.





PRERJA A-A, P 1:100




Lokacioni i Muzeut Arkeologjik ndodhet në brendësi të Qendrës Historike të Prizrenit, ndonëse krahasuar me të gjitha muzetë e Prizrenit, mbetet ndër muzetë më të panjohur për komunitetin.

Hapësirat e Muzeut Arkeologjik përbëjnë një rast të veçantë të adaptimit të një objekti të trashëgimisë kulturore në një muze, në të cilin ndriçimi zenital mbetet ndër elementet më karakteristike.

Ekspozita e përhershme e muzeut është e vendosur në përdhësë të objektit, përdherisa për ekspoziturë të përkohshme është përdorur struktura e shkallëve të Sahat Kullës. Një pjesë e eksponateve ndodhet edhe në oborrin e muzeut.







Artefaktet e Muzeut Arkeologjik janë ekspozuar kryesisht në korniza ekspozuese të mbyllura, ndërsa një numër i caktuar i tyre qëndrojnë në mënyrë të pavarur. Muzeu dallohet për një ekspozitë mirë të strukturuar, me mobiluar dhe ndriqim adekuat, ndonëse pengesë përbënë mungesa e përshkrimeve tekstuale me të dhëna mbi muzeun në përgjithësi dhe ekspozitën në veçanti.





- Hapësirat e paqashme për personat me aftësi të kufizuara
- Sahatkulla e qasme vetëm përmes shkallëve
- Hapësirat e qasme me rampa
- Disnivelimi në hyrje të ndërtesës
- Disnivelimi në hyrje të oborrit




Hapjet në mes të kthinave janë shumë të ngushta



Shkallët e sahatkullës janë shumë të pjerrëta




Mungon WC për personat me aftësi të kufizuara




Problemet në qasshmëri kjo ndërtesë i ka prezente që në hyrje të oborrit (a), ku ka disnivel.

Kjo poashtu është prezente edhe në qasjet e ndërtesës (b), si dhe në mes të kthinave. Tutje në shkallët e Sahatkullës hasim thellësi të pamjaftueshme të pushimoreve (c) dhe qasje vetëm me shkallët ekzistuese që janë mjaft të thepisura.




ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT



- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina direkte pas kthinës së parë të muzeut
- 2 - Kthina direkte pas dy hapësirave të para të muzeut
- 3 - Kthina direkte pas tri hapësirave të para të muzeut



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



- - Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë
- - Hapësirat të cilat kanë lidhje me 2 hapësira
- - Hapësirat të cilat kanë lidhje me më shumë se 2 hapësira
- - Hapësira e komunikimit vertikal që poashtu i lidhë dy hapësira


ANALIZA E ZHVILIMIT TË HAPËSIRAVE






- ~ Vija e lëvizjes së vizitorëve
- ↓ Drejtimi i lëvizjes
- Pika ku vizitori ka qëndruar më gjatë
- Vizitorët që vetëm kanë realizuar foto nga jashtë






- Hapësirat më pak të vizituara - ●
- Hapësirat e vizituara mesatarisht - ●
- Hapësirat e vizituara më së shumti - ●
- Pikat më atraktive për vizitorët - ●




### ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE NË MUZEUN ARKEOLOGJIK

Muzeu Arkeologjik i takon tipologjisë komplekse të zhvillimit të hapësirave ekspozuese, duke qenë se sekuenca e lëvizjes së vizitorëve nuk zhvillohet në një trajektore të rregullt, lineare. Përkundrazi, mundësia e qasjes së vizitorëve në dy hapësira fillestare, zhvillon mundësinë që vizitorët të përshkruajnë sekuenca të ndryshme të lëvizjes. Muzeu karakterizohet për kthina me thellësi të ndryshme, ku maksimumi i thellësive shënohet në hapësirat që kanë lidhshmëri me tri hapësira të tjera. Janë pikërisht këto hapësira të cilat rezultojnë të jenë më të frekuentuarat. Në të kundërtën, ekzistojnë hapësira të cilat rrezikojnë të jenë më pak të frekuentuara, ndaj të cilave rekomandohet ritrajtim i ekspozitës, përmes vendosjes së elementeve ekspozuese më tëherqëse, në krahasim me kthinat qëndrore ku domosdosshmërisht ekziston frekuentim më i madh i vizitorëve.



- A - ●
- B - ●
- C - ●
- D - ●

- A - Hapësirat që lidhen me 1 hapësirë tjetër
- B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera
- C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera
- D - Hapësira që lidhet me komunikim vertikal



Hyrja-⊕

- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina e dytë e muzeut
- 2 - Kthina e tretë e muzeut
- 3 - Kthina e katërt e muzeut



MUZEU ETNOLOGJIK








### **MUZEU ETNOLOGJIK – SHTËPIA E SHEHZADES**

Muzeu Etnologjik i Prizrenit operon në shtëpinë tradicionale të qytetit të Prizrenit, e njohur si Shtëpia e Shehzades.



Shtëpia e Musa-Efendi Shehzades gjendet në pjesën rrafshinore të qytetit në rrugën e “Sarajit të Vjetër” dhe është ndërtuar në fund të shek. XVIII. Është objekt banimi i tipit rrafshinor, i ngritur në kate. I takon objekteve jo simetrike. Objekti është i pasur me elemente etnografike në enterier. Vlenë të theksohen oxhaqet e përpunuara që gjenden një në përdhese dhe dy në kate. Edhe drugdhendja është e pasur sidomos përpunimi i tavaneve (“Xhyl-tavan”), dollapëve, musëndrave etj. Në fasadën kryesore që gjendet në anën lindore janë punuar timpanore prej druri që janë karakteristike edhe për disa shtëpi tjera të qytetit të Prizrenit. Pas viteve ‘80 të shek. XX objekti nuk shfrytëzohet për banim ndërsa së fundmi në të zhvillon aktivitetin e vet Muzeu Etnologjik .

Muzeu prezenton koleksionin etnologjik të veshjeve të ndryshme tradicionale dhe eksponateve numizmatike të shqiptarëve të Prizrenit dhe komunitetit goran të regjionit të Opojës .
















Muzeu Etonologjik karakterizohet për faktin që vepron në një shtëpi tradicionale të Prizrenit, në të cilën kthinat e banimit individual kanë akomoduar në mënyrë të natyrshme eksponatet nga etnologjia. Ndërtesa e Muzeut Etonologjik i ofron vizitorit një përjetim të veçantë përmes masës natyrore, ndersa kthinat e shtëpisë akomodojnë veshje të ndryshme tradicionale të rajonit të Prizrenit.








Megjithëse i pasur me numër të madh të artefakteve, Muzeu Etnologjik i Prizrenit nuk gëzon mirëmbajtje të duhur; kjo është e vërejtshme nga oborri i neglizhuar me potencial të pashfrytëzuar, deri tek artefaktet e pluhurosura e me ndriçim të pamjaftueshëm.



- Hapësirat e papërshtatshme për personat me aftësi të kufizuara
- Hapësirat e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara
- Hapësirat e mbyllur për vizitorë
- Pragu në hyrje të ndërtesës



Shkallët janë shumë të pjerrta dhe i vetmi opion i ngjitjes në kat




Disnivele i pranishëm në hyrje dhe në brendi të ndërtesës.

Dyshemeja me gurë në trotuar dhe në një pjesë të oborrit, e papërshtatshme për personat me aftësi të kufizuara.




Në fotot e mësipërme shihet se që në hyrje të oborrit ka dysheme joadekuete për lëvizjen me karroca, dhe ballkoni i jashtëm është i qasshëm vetëm me shkallë. Në hyrje të ndërtesës ka prag, brenda ka disnivele, ndërsa kati i parë është i arritshëm vetëm përmes shkallëve që nuk janë aq praktike.


ANALIZAT NË KATIN E PARË:




ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT




ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE




ANALIZAT NË PËRDHESË:



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Hapësirë e mbyllur për vizitorët - ●

- Kthina e parë e muzeut - 0
- Kthina direkte pas kthinës së parë të muzeut - 1
- Kthina direkte pas kthinës së dytë të muzeut - 2
- Kthina direkte pas kthinës së tretë të muzeut - 3
- Ballkoni i jashtëm i muzeut - J

- Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë - ●
- Hapësirat të cilat lidhen me 2 hapësira - ●
- Hapësirat të cilat lidhen me më shumë se 2 hapësirë - ●
- Ballkoni i jashtëm - ●







### ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE NË MUZEUN ETNOLOGJIK

Muzeu Etnologjik i takon tipologjisë qendrore të zhvillimit të hapësirave ekspozuese, duke qenë se sekuenca e lëvizjes së vizitorëve zhvillohet me shpërndarje nga holli hyrës – qëndror, në kthinat anësore. Edhe pse objekti në fjalë është adaptuar së fundmi në muze (duke qenë shtëpi individuale në gjendjen e vet burimore) dhe nuk është projektuar si i tillë, megjithatë ai përbën një rast tipik të muzeve me tipologji qendrore. Rrjedhimisht, kthinat perimetrike të muzeut rezultojnë të jenë kthina me thellësi më të madhe, disa nga të cilat lidhen me nga një hapësirë tjetër. Një tipologji e tillë kërkon kujdes të shtuar në mënyrën e ekspozimit të eksponateve, në mënyrë që vizitorët të jenë mirë të orientuar, duke u siguruar që të gjitha kthinat e muzeut të jenë plotësisht të vizituar, duke eliminuar hamendësimin eventual. Lidhur me këtë, ekspozita momentale e Muzeut Etnologjik kërkon rikonceptim dhe ridizajnim, përmes një rivendosjeje të eksponateve dhe përmes përshkrimeve orientuese të vizitorëve.

SKEMA E PËRDHESËS:




SKEMA E KATIT 1:




- A - ●
- B - ●
- C - ●
- D - ●

- A - Hapësirat që lidhen me vetëm 1 hapësirë tjetër
- B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera
- C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera
- D - Hapësirat që lidhen me komunikim vertikal

SKEMA E PËRDHESËS:



SKEMA E KATIT 1:




Hyrja-⊕

- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina e dytë e muzeut
- 2 - Kthina e tretë e muzeut
- 3 - Kthina e katërt e muzeut

MUZEU I KOMPLEKSIT TË LIDHJES  
SHQIPTARE TË PRIZRENIT








## **MUZEU I LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT**

Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit është një kompleks muzeor dhe monument i trashëgimisë kulturore në qytetin historik të Prizrenit. Kompleksi i Lidhjes së Prizrenit, si tërësi urbanistike dhe arkitektonike në aspektin hapësinor shtrihet në bërthamën e vjetër të qytetit të Prizrenit dhe ka vlerë të veçantë kulturore, historike, arsimore, shoqërore dhe ambientale. Në kuadër të Kompleksit ndodhen Ndërtesa e Lidhjes së Prizrenit, Muzeu, Biblioteka dhe Leximorja, Galeria e Arteve, Medreseja, Xhamia e Gazi Mehmet Pashës, Tyrbeja si dhe objektet e banimit.


Në këtë kompleks është mbajtur Lidhja e Prizrenit - një organizim politik i vilajeteve shqiptare më 10 qershor, 1878 e që si qëllim kishte mbrojtjen e territoreve shqiptare nga aneksimi i shteteve fqinjëve dhe bashkimin e shqiptarëve në një vilajet autonom.

Kompleksi ka pësuar ndryshime dhe dëmtime të njëpasnjëshme, përmes dislokimit të strukturave ekzistuese, rrënimeve dhe së fundmi, përmes djegjes së tërësishme të Rezidencës Qeveritare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Të gjitha këto ngjarje kanë ndikuar edhe në devastimin e një pjese të ekspoziteve.












BAZA E PËRDHESËS SË LIDHJES, P 1:100




BAZA E PËRDHESËS SË LIDHJES, P 1:100









PRERJA A-A, P 1:100

Zhvillimet historike që e karakterizojnë këtë kompleks kanë bërë që ky muze të mbajë primatin e muzeve më të vizituara të qytetit të Prizrenit. Megjithatë, mënyra e ekspozimit të eksponateve, mungesa e mobiliarit dhe ndriçimit adekuat, poashtu mungesa e informimit të vizitorëve përmes shkrimeve informuese lidhur me llojin e eksponateve dhe periudhat të cilave ato u takojnë, përbën një mangësi serioze të këtij muzeu.





PRERJA B-B, P 1:100

Hapësira muzeale e muzeut të Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit karakterizohet me dy objekte ekspozuese, përkatësisht objektit të Rezidencës Qeveritare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe njëkohësisht objektit të Medresesë së Mesme të "Gazi Mehmet Pashës". Muzeu operon i ndarë në tre sektorë, sektorin e historisë (të vendosur në Rezidencën Qeveritare) dhe sektorin e etnografisë dhe të galerisë së arteve (të vendosur në objektin e Medresesë).







FASADA VERIPËRËNDIMORE, P 1:100



FASADA JUGPËRËNDIMORE, P 1:100

Muzeu i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit përbën një rast secifik të muzeve të qytetit të Prizrenit, duke qenë se zhvillohet në një kompleks urb-arkitektonik, i cili është shndërruar në një atraksion për turistë vendore dhe të huaj. Karakteristikë e këtij kompleksi është masa monumentale, e manifestuar në enterier dhe në eksterier.




MEDRËSEJA, FASADA JUGLINDORE, P.1:100






Përdhesa e objektit të Rezidencës Qeveritare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit shërben vetëm në formë të hollit hyrës për muzeun i cili zhvillohet në hapësirat e katit të parë, dhe posedon poashtu një zyre për stafin administrativ. Ndërsa, përdhesa e objektit të Medresesë së Mesme të "Gazi Mehmet Pashës" shërben për ekspozimin e eksponateve të sektorit të etnografisë, bashkë me hapësira utilitare, siç janë toaletet për vizitorë dhe një depo e hapur e Muzeut.








Në katin e parë të objektit të Rezidencës Qeveritare të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit janë të vendosura eksponatet e sektorit të historisë. Ndërsa, në katin e parë të Medresesë së Mesme të "Gazi Mehmet Pashës" janë ekspozuar eksponatet e galerisë së artit. Në fund të këtij sektori është poashtu një hapësirë për ekspozimin e ekspozitave të përkohshme, përderisa ky kat akomodon edhe zyret për stafin udhëheqës dhe profesional të kompleksit.







Këto fotografi shfaqin disa nga problemet kryesore  
prezente në qashtëri të përdhësës së kompleksit.




Shkallët e ngushta  
dhe i vetmi opsion  
i ngjitjes në kat

Disniveli i pranishëm  
në hyrje dhe në  
brendi të ndërtesës

Kati i ulët  
pengon gjatë  
ngjitjes në shkallë.


○ Disniveli në hyrje të oborrit  
● Hapësirat e paqashtme për personat me aftësi të kufizuara  
● Shkallët e ngushta, të pjerrëta dhe e vetmja mënyre e ngjitjes në kat







● Hapësirat e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara  
● Shkallët e ngushta, të pjerrëta dhe e vetmja mënyre e ngjitjes në kat








ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT




ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE





- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina direkte pas kthinë së parë të muzeut
- 2 - Kthina direkte pas dy hapësirave të para të muzeut
- 3 - Kthina direkte pas tri hapësirave të para të muzeut
- 4 - Kthina direkte pas katër hapësirave të para të muzeut
- H - Kthinë e hapurë e shfrytëzuar si depo

ANALIZA E HAPËSIRAVE NË PËRDHESË TË NDËRTESES SË LIDHJES TË PRIZENIT


- Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë
- Hapësirat të cilat kanë lidhje me 2 hapësira
- Hapësirat të cilat kanë lidhje me më shumë se 2 hapësira
- Hapësira e jashtme të deponimit




ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT



ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina direkte pas kthinës së parë të muzeut
- 2 - Kthina direkte pas dy hapësirave të para të muzeut
- 3 - Kthina direkte pas tri hapësirave të para të muzeut
- 4 - Kthina direkte pas katër hapësirave të para të muzeut
- 5 - Kthina direkte pas pesë hapësirave të para të muzeut


ANALIZA E HAPËSIRAVE NË KATIN E PARË TË NDËRTESES SË LIDHJES TË PRIZRENIT

- - Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë
- - Hapësirat të cilat kanë lidhje me 2 hapësira
- - Hapësirat të cilat kanë lidhje me më shumë se 2 hapësira



-NR. I VIZITORËVE 35 29 9 5 4 3 2 1 0

G B



11-12

13-14

15-16

ORA:

Vija e lëvizjes së vizitorëve

Drejtimi i lëvizjes

Pika ku vizitori ka qëndruar më gjatë

Vizitorët që vetëm kanë realizuar foto nga jashtë



-NR. I VIZITORËVE 35 29 9 5 4 3 2 1 0

G B

11-12  
13-14  
15-16  
ORA:

~ Vija e lëvizjes së vizitorëve  
- Drejtimi i lëvizjes  
• Pika ku vizitori ka qëndruar më gjatë  
○ Vizitorët që vetëm kanë realizuar foto nga jashtë










- Hapësira e personelit - ●
- Hapësirat e pavizituara - ○
- Hapësirat e vizituara mesatarisht - ●
- Hapësirat e vizituara më së shumti - ●
- Pikat më atraktive për vizitorët - ★



## ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE NË MUZEUN E LIDHJES SHQIPTARE TË PRIZRENIT



Muzeu i Kompleksit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit i takon tipologjisë komplekse dhe asaj lineare të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Më konkretisht, objekti i Rezidencës Qendrore të LSHP-së ka tipologji lineare, ndërsa objekti i Medresesë së Mesme "Gazi Mehmet Pasha" ka tipologji komplekse, e vijuar me një linearitet. Në këtë objekt është karakteristik fakti që sekuencat e lëvizjes zhvillohen në një linearitet të theksuar në drejtimin perëndimor të objektit, duke determinuar që vizitorët të hyjnë në hapësirat ekspozuese dhe të dalin në të njëjtin drejtim, apo më specifikisht, të përsërisin sekuencën hyrëse dhe dalje në të njëjtin mjedis.

Përgjatë analizës së lëvizjes së vizitorëve në tri intervale të ndryshme kohore, është vërejtur se një numër i konsiderueshëm i vizitorëve qaset në këtë muze vetëm për vizitë në oborrin e kompleksit. Poashtu, është vërejtur që hapësirat më së paku të frekuentuara mbeten hapësirat e fundme të objektit të Medresesë, të cilat për shkak të thellësisë së zhvillimit si hapësira, humbasin interesimin e vizitorëve.

Skema e ndërtesës së L.Sh.P:



SKEMA E KATIT 1:



SKEMA E PËRDHESËS:



Skema e ndërtesës së Medresesë:



- A - ●
- B - ●
- C - ●
- D - ●

- A - Hapësirat që lidhen me vetëm 1 hapësirë tjetër
- B - Hapësirat që lidhen me 2 hapësira të tjera
- C - Hapësirat që lidhen me më shumë se 2 hapësira të tjera
- D - Hapësirat që lidhen me komunikim vertikal

Skema e ndërtesës së L.Sh.P:



SKEMA E KATIT 1:



SKEMA E PËRDHESËS:



Skema e ndërtesës së Medresesë:




Hyrja-⊕

- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 1 - Kthina e dytë e muzeut
- 2 - Kthina e tretë e muzeut
- 3 - Kthina e katërt e muzeut
- 4 - Kthina e pestë e muzeut
- 5 - Kthina e gjashtë e muzeut

MUZEU I KALASË SË PRIZRENIT








## **MUZEU I KALASË SË PRIZRENIT**


Muzeu i Kalasë është themeluar në vitin 2016, në lokalitetin Arkeologjik të Kalasë. Gjetjet e ndryshme të periudhave të ndryshme historike që janë zbuluar gjatë gërmimeve në kala dhe përrreth zonës janë vendosur në këtë muze, i cili bartë karakterin e një muzeu me ekspozitë të përhershme.

Kalaja e Prizrenit konsiderohet të jetë simboli i qytetit të Prizrenit dhe një element me rëndësi në identitetin kulturor të Kosovës. Ajo përmban në vete një pjesë të rëndësishme të historisë së lashtë të qytetit. Pozicioni i saj topografik, dominues mbi qytetin, peizazhi natyror mjaft tërheqës dhe konfigurimi arkitektonik i menduar mjaft mirë e bëjnë këtë monument me vlera të padiskutueshme arkeologjike, historike dhe turistike. Muret fortifikuese ndjekin izohipset e terrenit duke rrethuar një sipërfaqe rreth 1.5 ha në trajtë përafërsisht vezake me zgjatje veri-jug.













Muzeu i Kalasë përbën një rast të veçantë në mesin e objekteve të tjera muzeale të qytetit të Prizrenit, duke qenë se si objekt është projektuar nga fillimi, për dallim nga muzetë e tjerë të cilët operojnë në objekte ekzistuese të trashëgimisë kulturore. Përgjithësisht, ky muze qëndron mirë sa i përket strukturimit të ekspozitës, mobiliarit, ndriçimit dhe informatave udhëzuese për vizitorët.



PRERJA A-A, P 1:100




Vazhdimi i gërmimeve arkeologjike të bëra në vitet 2004 dhe 2009, 2010 dhe 2011 dha rezultate shtesë të cilat ndikuan dhe në themelimin e Muzeut të Kalasë. Për herë të parë u dokumentuan dëshmi të një vendbanimi parahistorik të datuar paraprakisht në epokën e bronzit dhe periudhën e hershme të hekurit i cili ka shërbyer si bërthama e parë e jetës në këtë vend. Sot ky muze përbën një atraksion për vizitorët potencial dhe një arsye më shumë për të vizituar Kalanë e Prizrenit.




FASADA PERËNDIMORE, P 1:100






Kalaja e Prizrenit përbën një atraksion unik për këtë qytet. Rrjedhimisht Muzeu i Kalasë ka fluks të madh vizitorësh, sidomos gjatë verës. Vitrinat ekspozuese përmbajnë narracionin në gjuhën shqipe dhe angleze dhe kanë renditje kronologjike.









Siç shihet në këto foto, Muzeu i Kalasë së Prizrenit nuk është i qasshëm nga personat me aftësi të kufizuara, për shkak se dyshemeja në oborrin e kalasë është e shtruar me gurë që e pamundësojnë lëvizjen deri tek muzeu. Megjithatë, muzeu posedon rampa mobile për disnivelim në hyrje, ndërsa brenda nuk ka ndërrim nivelesh.






ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE



- Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë
- Hapësirat të cilat nuk lidhen me hapësira të tjera

- 0 - Kthina e parë e muzeut
- 0/1 - Kthina e parë e muzeut & kthina direkte pas kthinës së parë të muzeut


ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE






### ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE NË MUZEUN E KALASË SË PRIZRENIT

Muzeu i Kalasë i takon tipologjisë linare të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Edhe pse në shikim të parë, konsideruar edhe katër parakthinat me përmbajtje shtesë, ky muze mund të duket me zhvillim kompleks, në realitet hapësira ekspozuese është e shtrirë në linearitet, duke stimuluar një sekuencë të pastër të lëvizjes. Hyrja dhe dalja e objektit janë të dizajnuara në dy pozicione diametralisht të kundërta, duke determinuar që hyrja dhe dalja e vizitorëve të jenë në mjedise të kundërta, pa patur nevojë që vizitori të përshkojë dy herë të njëjtën hapësirë.




A - Hapësirat që lidhen me 1 hapësirë tjetër  
X - Hapësirat që nuk lidhen me asnjë hapësirë tjetër




0 - Kthina e parë e muzeut  
0/1 - Kthina e parë e muzeut & kthina direkte pas kthinës së parë të muzeut

MUZEU I HIDROELEKTRANĒS









### **MUZEU I ELEKTROEKONOMISË – HIDROELEKTRANA “PRIZRENASJA”**


Muzeu i Elektroekonomisë së Kosovës i njohur në fillimet e tij si "Hidroelektrana Prizrenasja" është një monument i trashëgimisë kulturore në Prizren. Ndërtesa e Muzeut të Elektroekonomisë së Kosovës apo Hidroelektrana "Prizrenasja" gjendet në ambientin piktoresk të Grykës së Lumbardhit, 2.5 km larg Prizrenit. Është ndërtuar në vitin 1926-28 me kontributin e qytetarëve dhe kredive bankare. Ndërtesa është projektuar dhe ndërtuar nga një kompani austriake nga Vjena. Objekti ka pasur elementet moderne të asaj kohe: turbinat e ujit, pjesën për pastrimin e ujit nga mbeturinat, kanalin, pajisjet për përcjelljen e ujit gjer në turbinë dhe gjeneratorin me fuqi 160 KW. Për shkak të kërkesës së madhe të energjisë elektrike në vitin 1936 është lëshuar në qarkullim gjeneratori i dytë me kapacitet të njëjtë. Në vitin 1979 kjo ndërtesë e rëndësishme për historinë industriale të qytetit është shndërruar në Muze të Energjisë Elektrike të Kosovës. Muzeu ka funksionuar deri në mes të viteve të 80'ta të shekullit të kaluar. Pas një periudhe të gjatë të mungesës së mirëmbajtjes, në vitin 2011 objekti është restauruar. Muzeu i Energjisë Elektrike i vendosur në një ndërtesë historike "Hidroelektranë" paraqet një shembull unik për Kosovën për trajtimin e objekteve industriale si trashëgimi kulturore.






















PRERJA A-A, P 1:100

Muzeu i Elektroekonomisë - Hidroelektrana "Preizrenasja" ka të ekspozuar vetëm pjesë të makinerive të kohës kur ka funksionuar si hidroelektranë, dhe disa pjesë të sistemit elektrik në oborr. Mund të konsiderohet ndër muzetë më karakteristik të rajonit, duke qenë se prezenton një lëmi karakteristike të muzeve, atë të zhvillimit të elektroekonomisë në vend. Sidoqoftë, muzeu është aktualisht i mbyllur dhe pa ekspozitë të strukturuar.










FASADA VERIORE, P 1:100

Muzeu i Elektroekonomisë karakterizohet me një peizazh rrethues atraktiv, i lokalizuar në dalje të strukturës urbane të qytetit të Prizrenit. Oborri i muzeut karakterizohet me një vegetacion të pasur, ndërsa vetë objekti prezenton një strukturë arkitektonike tërheqëse, të rinovuar së fundmi.





NDËRTESA NË RAPORT ME NATYRËN







Muzeu i Elektroekonomisë dallohet me një peizazh rrethues shumë tërheqës. Kjo bashkë me vet karakterin e ndërtesës ia shton vlerën muzeut. Një tjetër potencial që ka kjo ndërtesë është kulmi i shfrytëzueshëm. Në fotot e bashkangjytua vihet re se oborri mirëmbahet mjaft shumë, ndërsa brendia e ndërtesës ka dëmtime biologjike, përkatësisht myku në mure veriore.







IDENTIFIKIMI I PENGESAVE NË QASSHMËRI TË PËRDHESËS



IDENTIFIKIMI I PENGESAVE NË QASSHMËRI TË KLUMIT TË SHFRYTËZUESHËM


- Gardhi i pasigurtë për fëmijë
- Shkallët, komunikimi i vetëm vertikal
- Hapësirë e pasigurtë për shkak të hapjeve në dysheme
- Hapësirë e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara
- Oborri i shtruar me gurë, i pashfrytëzueshëm nga personat me aftësi të kufizuara




Në fotot e mësipërme shihet se ndërtesa është e paqasshme për personat me aftësi të kufizuara, pasi që që në hyrje të oborrit, dyshemeja e shtruar me gurë e pamundëson lëvizjen deri tek hyrja në përdhesë. E përdherisa kati i parë nuk është i hapur për vizitorët, kati i dytë/terrasa mund të arrihet vetëm përmes shkallëve.





ANALIZAT NË KATIN E PARË:





ANALIZAT NË PËRDHESË:



ANALIZA E NDËRLIDHJES SË KTHINAVE TË MUZEUT



ANALIZA E THELLËSISË SË ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE




ANALIZA E ZHVILLIMIT TË HAPËSIRAVE

Hapësirë e mbyllur për vizitorë - ●

Kthina e parë e muzeut - 0  
Kthina direkte pas kthines së parë të muzeut - 1


Hapësirat të cilat lidhen vetëm me 1 hapësirë - ●  
Hapësira hyrëse e cila nuk lidhet me hapësira të tjera - ●






### ZHVILLIMI I HAPËSIRAVE NË MUZEUN E HIDROELEKTRANËS "PREIZRENASJA"

Muzeu i Elektroekonomisë - Hidroelektrana "Preizrenasja" i takon tipologjisë lineare të zhvillimit të hapësirave ekspozuese. Karakteristikë e këtij muzeu është fakti që hapësira ekspozuese është e organizuar si tërësi funksionale në mënyrë jashtëzakonisht të thjeshtë, duke stimuluar një lëvizje lineare të vizitorëve. Kthina hyrëse përbën kthinën kryesore të muzeut, përdërisa ajo është e lidhur me një hapësirë të dytë në të cilën përfundon qarku i lëvizjes së vizitorëve në përdhese. Kati i parë i muzeut është pa ndonjë funksion të caktuar dhe i pa shfrytëzuar.



A - Hapësira që lidhet me 1 hapësirë tjetër  
B - Hapësira që lidhet me 1 hapësirë tjetër dhe stimulon kthimin prapa



0 - Kthina e parë e muzeut  
1 - Kthina e dytë e muzeut

PËR TË LEXUAR DOKUMENTIN NË FORMË  
LIBRI SKENO KODIN:





EC  
WE ALLYSEI

